


Në roje të kufirit

85H-32

R. 76



NDREKO RINO

891.983-32

NDREKO RINO

S

R76

NË ROJE TË KUFIRIT

~~37862~~

2188

LIBRARIJA E SHTETIT
FRASHËRI

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Ilustrimet: Fatmir Haxhiu

Kopertina: Safo Marko

Tirazhi 5000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»

Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë 1970

Këtë përmbledhje të vogël ngjarjesh
dhe tregimesh të jetuara ua kushtoj kufi-
tarëve trima dhe kufitarëve pa uniformë
— banorëve trima të brezit e të zonës ku-
fitare — me rastin e 25-vjetorit të armës
së kufirit.

Autori

K U F I A K T I V

Kufitë e Shqipërisë dhe tokat shqiptare i mbron një popull dhe një parti që u derdh plumb në gojë të gjithë atyre që do të guxojnë t'i prekin»

ENVER HOXHA

Ishte viti 1952. UDB-ja jugosllave dërgonte në vendin tonë njërin pas tjetrit, në një kohë dhe në disa drejtime, duke i mbështetur në disa raste edhe me zjarr nga territori jugosllav, grupe diversantësh të përbëra prej 2-10 vetësh. Në një rast ndodhi kështu:

Ora po numëronte minutat e fundit të datës 19 maj. Komandantin e repartit kufitar e kishin zgjuar dy herë gjatë asaj nate. Dhe ja, zilja e telefonit po binte përsëri.

Komandanti u ngrit u vesh, u armatos dhe kur po dilte i tha së shoqes: «Flij ti, me sa duket nuk do të kthehem shpejt».

Ç'kishte ndodhur në kufi?

Operativi i repartit e informoi komandantin se rreth orës 18, në pyllin e vogël të katundit

Petrushë të rrethit të Pogradecit, grupi i pushkatarëve që ndeshur në befasi me dy diversantë të UDB-së jugosllave. Diversantët kishin shkëputur kontaktin me njëri-tjetrin dhe ishin larguar në drejtim të panjohur. Forcat tona ishin në lëvizje për kapjen ose likuidimin e diversantëve.

Komandanti urdhëroi që të mbyllej mirë kufiri në drejtimet nga ku mund të lëviznin diversantët, të forcohej blokimi i rajonit ku mund të ndodhej grupi i diversantëve dhe të përgatiteshin forcat e kërkimit, të cilat, duhej të fillonin nga veprimet.

Aty nga ora 5 e mëngjezit, në vendkomandë arriti e dhëna se një nga grupet tona të kërkimit, në orën 4.30 kishte rënë në përpjekje me dy persona të armatosur. Por ndeshja s'kishte dhënë përsëri rezultat dhe diversantët ishin larguar me shpejtësi në drejtim të kufirit nga kishin ardhur.

— E, si thoni ju? — i kërkoi mendimin komandanti shefit të zbulimit. — Do të na shpëtojë ky grup tradhëtarësh e vrasësish?

— Të gjitha të dhënat tregojnë se nuk do të ndodhë një gjë e tillë, shoku komandant. Fakti, që ne u përpoqëm me ta, është një tregues i mirë që vërteton se grupi diversionist nuk e ka kaluar kufirin dhe që përcakton rajonin ku mund të ndodhet ai. Duke u mbështetur në këto, forcat tona mund të veprojnë me sukses, vetëm duhet të mos humbasim kohë.

— E drejtë! Por a kemi bërë llogari se ku mund të ndodhet për afërsisht grupi i diversantëve në këto çaste kur ne bisedojmë?

— Po, shoku komandant. Për llogaritja është e thjeshtë, — vijoi zbuluesi. — Përpjekja ndodhi

25.26

rreth orës 4.30 minuta. Tani është ora 5, pra nga çasti i përpjekjes kanë kaluar 30 minuta. Gjatë kësaj kohe, diversantët, sado me shpejtësi që të kenë lëvizur, nuk mund të jenë larguar më shumë se 2 km. Kështu që ata tani duhet të ndodhen brenda rajonit të bllokuar. Në lidhje me këtë situatë, mendoj të vazhdohet kërkimi, të vihen në dijeni forcat e blokimit mbi përpjekjen në mënyrë që ta shtojnë më shumë vigjilencën. Një pjesë e rezervës të dërgohet për forcimin e kufirit në drejtimin e lëvizjes së grupit diversionist.

Propozimet e zbuluesit me eksperiencë shumëvjeçare, me disa sugjerime, u aprovuan dhe u dhënë urdhërat për zbatim.

Kërkimi i agjentëve jugosllavë vazhdonte me kujdes të madh. Në kufi ishte shtuar numri i patrullave dhe i njësiteve të tjera. Por edhe në anën tjetër viheshin re lëvizje. Ushtarë jugosllavë, të armatosur me mitralozë të lehtë e të rëndë, i qenë afruar vijës së kufirit, ishin vendosur në pozicione gjysmë të maskuara dhe qëndronin në pritje.

Dita agoi e mrekullueshme. Dielli sapo kishte lindur; bari i njomë, të lashtat e gjelbëra, qyteti piktoresk, liqeni i kaltër dhe gurgullimat e përroit të Çeravës i jepnin natyrës së atyre viseve një pamje poetike.

Komandanti, së bashku me grupin operativ, kishte dalë mbi një nga kodrat zotëruese, kishte vënë dylbinë dhe po vrojtonte rajonin e veprimeve. Atij i vinin në mendje mendime të ndryshme, të lidhura me zbatimin e urdhërit për asgjësimin e grupit diversionist. Por ja, duke vërtitur dylbinë, atij i kapi syri piramidën, vijën e kufirit, territorin jugosllav, ushtarët e vendosur në pozi-

cione dhe tytat e armëve, të drejtuara nga territori ynë.

— I shikon — ju drejtua ai oficerit që kishte pranë, — armiqtë kanë dalë të korrin farën që mbollën... Si thoni, do t'ja arrijnë qëllimit?

— Siç shikoj unë, ata do t'a pësojnë si dhelpira... Megjithatë, është mirë të porositen edhe një herë postat e kufirit të këtij sektori, që gjatë veprimeve të kenë kujdes nga shpina.

Komandanti tundi kokën në shenjë aprovimi, por nuk arriti t'i përgjigjej oficerit. Bisedën e ndërpre në krismë armësh që oshëtinë në pyllin jo shumë larg. Korierët mbërritën me shpejtësi e njoftuan se një nga pritat tona kishte dëgjuar zhurmë në pyll e kishte parë të afrohej njërin prej diversantëve. Prita e kufirit e ndaloi shkelësin. Diversanti zbrazi me shpejtësi një breshëri automatiku dhe qe larguar. Por, pas nja dyqind metrash, ai qe ndeshur me patrullën tjetër, dhe qe detyruar të zinte pozicion e të mbrohej.

Kufitarët synonin ta kapnin të gjallë armikun, atyre u duhej «gjuha».

Forcat tona e ngushtuan mirë darën e rrethimit dhe i bënë thirrje diversantit të dorëzohej, por ai nuk përgjigjej. Më vonë, një zë i mbytur u dëgjua që përtej:

— Ej, komunistë! Jam gati të dorëzohem, po nuk ngrihem dot se jam plagosur në të dyja këmbët. Dërgoni 2-3 veta të më marrin.

Mirëpo, përgjegjësi i rrethimit nuk u shpejtua. I regjur në luftë me bandat diversante, ai dyshoi nga ky vendim i papritur i shkelësit të kufirit dhe vendosi ta provonte. Ai caktoi dy ku-



fitarë që t'i afroheshin me kujdes pozicionit të armikut. Të dy kufitarët filluan lëvizjen, por nuk kaloi as një minutë, kur para tyre plasën, njëra pas tjetrës, granatat. Në përgjigje të këtij veprimi banditesk, mbas disa sekondash, në strofku llën e diversantit shpërthyen granatat e kufitarëve. Banditi e pagoi me lëkurën e vet.

Në të njëjtën kohë edhe pjesa tjetër e forcave tona që ndeshur me diversantin e dytë, jo më larg se një kilometër nga vija e kufirit. Kufitarët si e rrethuan mirë edhe këtë kriminel, bënë gjithshka për ta kapur të gjallë. Por agjenti nuk u dorëzua, ai inkurajohej nga mitralozët e lehtë dhe të rëndë të forcave ushtarake jugosllave, të cilët villnin zjarr mbi territorin tonë, në shpinë të kufitarëve, për të lehtësuar lëvizjen e agjentit të tyre.

Udbashi që ishte ndarë nga shoku i tij qysh nga ora katër e gjysmë, kur dëgjoi zhurmën e armëve, vrapoi me shpejtësi në drejtim të kufirit. Por edhe ai nuk i shpëtoi dot syrit të mprehtë të kufitarëve. Ai në befasi u ndesh me një nënoficer tonin. Banditi i regjur, u mundua ta mashtronte kufitarin.

— Grupi i diversantëve që kërkoni është rrethuar. Ja ku është, — dhe bëri me dorë në drejtimin ku luftohej për kapjen e shokut të tij. — Unë nuk jam pjesëtar i grupit, — vijoi ai, — por më kanë marrë si rrugë-rrëfenjës, e u futa rastësisht në këtë dasmë.

Nënoficeri nuk ra në kurth. Me zë të fortë dhe gjithë urrejtje, i tha:

— Të njoh nga automatiku «Tomson» kush je ti, këlysh i Rankoviçit.

Predhat e automatikut e detyruan diversan-

tin të shtrihej barkas dhe të përgjigjej menjëherë me zjarr. Filloi edhe këtu përppjekja. Armiku përdori bombat e dorës e tymuese, për të çarë rrugën. Granata e tij e parë, ra brenda, pranë vendit ku ndodhej rreshteri. Ajo nuk plasi. Kufitari kundërveproi menjëherë, e kapi me shpejtësi bombën dhe e flaku andej nga i erdhi, dhe e la të vrarë diversantin. Edhe ky armik nuk i shpëtoi dot forcave tona.

Njëri nga ushtarët e kufirit, duke e shikuar me urrejtje kufomën e diversantit, i tha rreshterit:

— I lau edhe ky hesapet. E vratë me granatën e tij.

U vendos që kufomat e banditëve të çoheshin në katundin Petrushë, atje ku ata vranë dy pushkatarët tanë. Kur e ëma e njërit prej pushkatarëve të vrarë i pa banditët të shtrirë përpara saj, tha me urrejtje:

...Mua nuk më vjen keq që humba djalin, se ai ra për atdheun. Gjakun e djalit ja kam falur partisë. Ju lumtë, ju bëftë pushka top! Po të jetë nevoja, edhe unë do të luftoj me pushkën e tim biri.

EDHE TË LIRUAR, KUFITARË

Në një pikë zotëruese midis dy kokojkave gurore dhe jo më larg se 300 metra nga kufiri shtetëror, është dislokuar posta e kufirit. Sektori i saj nuk është i thyer, por në periudhën e shirave, pjesa dërmuese e sektorit të postës përmbytet dhe izolohet nga ujët.

Përpara postës kufitare gjarpëron Buna, një nga lumenjtë tanë më të mëdhenj, më të gjerë dhe i vetmi lumë i lundrueshëm. Në mes të këtij lumi kalon vija e kufirit. Buna u ka sjellë shumë të mira banorëve të kësaj krahine: ujët, peshkun, lundrimin për në Shkodër e anasjelltas, por bashkë me këto, nëpërmjet tij, kanë ardhur herë pas here diversantë dhe spiunë të UDB-së jugosllave.

Po afronte mesi i ditës. Koha ishte hapur dhe dielli digjte si në verë. Njësitë kufitar kishin më se pesë orë që vrojtonte e deri atëhere nuk kishte zbuluar ndonjë gjë me rëndësi. Kjo qetësi si dhe afrimi i kohës së ndërrimit, bëri që njëri nga kufitarët të jepte shenjë lodhjeje dhe të largonte vëmendjen nga shërbimi.

— A, kështu nuk bën, — i tha shokut të tij Myzaferi, përgjegjës i njësitit. — As sot, ditën

e fundit të shërbimit, nuk duhet të jemi më pak të kujdesshëm. Armiku mund të ketë marrë vesh se posta bën ndërrimin dhe mund të përpiqet ta shfrytëzojë këtë rast. Prandaj, përqëndrohu, duro dhe mos e hiq vëmendjen nga shërbimi.

Anëtari i njësitit, i cili ushqente respekt për Myzaferin, e kuptoi drejt kritikën e tij dhe menjëherë e mblodhi veten. Por, megjithatë, kur pa se koha e shërbimit që plotësuar dhe ndërresa ende nuk po vinte, i tha përgjegjësit:

— Shoku Myzafer! Komandanti i postës, kur na nisi, na tha se shërbimin e kemi me ndërrim. Koha kaloi, kurse ndërresa nuk po duket ende. Ti nesër do të lirohesh dhe të duhet kohë të përgatitesh.

— Edhe kjo vonesë është e lidhur me atë që të thashë më parë, me ardhjen e ushtarëve të rinj, prandaj mos u mërzit se komandanti e ka një hall. Unë dua që të vonohet edhe pak ndërresa sa të sqaroj diçka që kap me dylbi në këto minutat e fundit.

— Çfarë ke kapur?

— E shikon shkëmbin përtej.

— Po.

— Po hijen e tij e shikon?

— Shkëmbinjte në përgjithësi nuk lëvizin, por hieja e tij lëviz dhe ndërron formën.

— Në hijen e shkëmbit duhet të ketë diçka, kafshë ose njeri.

Nuk kaluan 10-15 minuta dhe hieja nuk lëvizi më. Të dy kufitarët kjo gjë i shqetësoi dhe forcuan më shumë vrojtimin, duke u përqëndruar te shkëmbi dhe duke kërkuar me kujdes përreth tij.

— Duhet të jenë zbulues, — i tha Myzaferi shokut të tij, — siç duket janë në vëzhgim. Janë maskuar mirë, prandaj duhet të kemi kujdes.

— Shoku Myzafer, midis shkëmbit dhe kaçubes diçka lëviz, është vështirë ta dallosh.

Myzaferi ju afrua shokut me kujdes dhe kur i pa dy siluetat që lëviznin, murmuriti: Ah maskarenjtë sa bukur janë maskuar, ka mundësi që sonte ose nesër të na dërgojnë «mysafirë». E pe që armiku nuk rri rahat? Kot nuk thotë populli: «Ujët fle, hasmi s'fle».

* * *

Dhoma e kulturës ishte mbushur plot. I gjithë efektiv, ushtarë të vjetër dhe të rinj, me përjashtim të atyre që ishin me shërbim, u grumbulluan. Kufitarët bisedonin me njëri-tjetrin me gjallëri. Kur komandanti doli në tribunë, në sallë ra qetësia.

— Shokë! Sot jemi mbledhur për përcjelljen e kufitarëve që lirohen dhe për të përshëndetur ushtarët e rinj — e filloi fjalën e tij komandanti. Lidhur me këto dy ngjarje, më lejoni që të parëve t'u uroj rrugë të mbarë, shëndet të mirë, suksese në punë dhe në jetë, ndërsa të dytëve t'u uroj mirëseardhjen, shëndet e shërbim të mbarë në ruajtjen e kufirit...

Pas përshëndetjes së shkurtër të komandantit, e mori fjalën njëri nga ushtarët që lirohej, i cili u zotua në emër të shokëve se edukimin, pregatitjen, kalitjen që ata kishin marrë në kufi do ta vinin në shërbim të popullit dhe të atdheut si

qytetarë të denjë të Republikës Popullore. — Ne, tha ai, nuk do ta harrojmë kufirin, do të jemi kurdoherë kufitarë dhe do të zbatojmë parullën tonë luftarake: të mbajmë në njërën dorë pushkën dhe në tjetrën kazmën.

Pas kufitarit që lirohej e mori fjalën edhe një nga të rinjtë, i cili në emër të grupit siguroi shokët dhe komandën se, së bashku me ushtarët e vjetër që mbeteshin, duke përfitur nga përvoja, ndihma e tyre dhe e komandës së postës, do të kryenin me vigjilencë të lartë detyrën e shenjtë, ruajtjen e kufirit shtetëror dhe stafetën që po merrnin nga ushtarët e vjetër do ta çonin përpara.

Ceremonia po merrte fund. Të gjithë efektivin e postës e kishte pushtuar një ndjenjë emocioni dhe entuziazmi. Në këtë çast, hyri njësitë vrojtues që sapo qe kthyer nga shërbimi.

— Shoku komandant, njësitë vrojtues që dorëzoi shërbimin ju paraqitet. Gjatë shërbimit tonë, ka të reja, të cilat do t'u raportohen veç, përgjegjësi i njësitit, tetar Lipellari.

— Mirë shoku Lipellari, tani takohu me ushtarët e rinj, pastaj hajde në zyrë të bisedojmë mbi të rejat. Tetar Lipellari është një nga kufitarët më të dalluar, që nesër lirohet, — sqaroi kufitarët e rinj komandanti i postës.

Ishte mbasdite. Komandanti me komisararin e postës, mbasi dëgjuan raportin e përgjegjësit të njësitit mbi të rejat nga vrojtimi, po mendonin për organizimin e shërbimit, i cili, sipas të dhënave, paraqitej i vështirë. Nga një anë e dhëna tregonte se pritej shkelje kufiri, nga ana tjetër, forcat ishin të pakta, shërbimi në kufi duhej të bazohej vetëm në ushtarët e vjetër që mbeteshin

në postë. Ushtarët që liroheshin në mëngjez herët duhej të largoheshin, ndërsa ushtarët e rinj nuk mund të venin në kufi që natën e parë, pa u njohur dhe pa u ambientuar me të.

Megjithatë, komanda e zgjidhi problemin duke aktivizuar nënoficerët e karrierës, grupet e bashkëveprimit vullnetar, dhe me ata mbylli drejtimet më të rëndësishme. Mirëpo, në kohën e numërimit luftarak, doli se një ushtar ishte sëmurë dhe nuk mund të delte në shërbim. Myzaferi e mori vesh këtë gjë, u paraqit me shpejtësi te komandanti dhe i tha:

— Më lejoni shoku komandat, të vete në vend të shokut tim në shërbim, që të mos e lëmë një nga drejtimet bosh.

— Tetar Myzaferi, jo, ti nuk mund të shkosh, sepse je liruar, nuk duhet dhe nuk kemi të drejtë të bëjmë një veprim të tillë.

— Kur është nevoja, ngrihet populli në këmbë për ruajtjen e kufirit. Llogariteni shërbimin tim si anëtar të grupeve të bashkëveprimit vullnetar. Për mua do të jetë nder i madh. Pastaj jo vetëm unë, por të gjithë ne, edhe të liruar, jemi kufitarë.

Komandanti i hodhi një sy komisarit, i cili aprovoi fjalën e kufitarit me një të lëvizur të kokës. Edhe komandanti e pranoi.

Nuk kaloi më shumë se një orë nga mbarimi i numërimit luftarak, kur në zyrën e postës u paraqit njësit i parë për të marrë detyrën.

Shoku komandant, njësit i kufitar i përbërë prej tetar... është gati të marrë detyrën luftarake për ruajtjen e kufirit shtetëror. Përgjegjësi i njësitit, tetar Lipellari.

— Qetësohuni shoku Lipellari. E, a i keni marrë pajimet, ai i dini sinjalet?

— Si urdhëron, — u përgjegj Myzaferi.

— Ju ngarkoj me detyrë për ruajtjen e kufirit shtetëror të RPSH. Lloji i njësimit «sekret». Itinerari i lëvizjes... Vendi i vendosjes... Sonte do të keni kujdes të veçantë nga drejtimi ... Qartë. Në zbatim!

* * *

45 minuta ju desh kufitarëve për të mbërritur në vendin e vendosjes. Retë e dendura që nizin qiellin e bënë edhe më të thellë errësirën e natës. Aty-këtu, ndonjë vetëtimë ndriçonte me dritën e saj verbuese. Myzaferi, si një kufitar me përvojë e dinte mirë se një natë e atillë u shërbente qëllimeve të këqia të armiqve të popullit dhe të partisë sonë. Ai që pak më parë mendonte për udhëtimin e nesërm, e kishte përqëndruar vëmendjen në ruajtjen e sektorit që i ishte besuar, të cilin e njihte mirë me çdo gur e drizë.

Njësiti ecte me kujdes midis kallamave, gjatë rrjedhjes së Bunës. Pas pak ju afrua vendit të caktuar dhe u vendos. Asgjë nuk dëgjohej veç përplasjes me furi të ujit te bregu i lumit. Orët e shërbimit po kalonin normalisht.

— Mirë do të jetë, — mendonte ai, — që tani, në ikje e sipër, t'i shpiem komandës së postës një peshqesh, spiunët ose diversantët e UDB-së jugosllave. Por ca si vështirë është. Ata sot vrojtuan në drejtim të tokës sonë dhe sot të futen? Pastaj ka mundësi që dy personat që u dukën sot në bre-

2188

~~51862~~

BIJOTEKA E BULEVARIT

1978

gun e kundërt, të mos jenë shkelësit që do të futen në territorin tonë, por oficerë të UDB-së jugosllave, të cilët kanë përcjellë ndonjë grup diversantësh disa ditë më parë dhe tani kanë dalë e i presin. Kështu që në mos kalofshin nga jashtë brenda, do të kalojnë nga brenda jashtë. Por edhe sikur të mos ketë fare sonte, unë prapëseprapë bëra detyrën time, ata do të vijnë nesër dhe atë që do ta bëja unë, ka për ta bërë ndoshta më mirë ndonjë nga shokët e mi.

* * *

Ishte afro mesi i natës. Në lumë u dëgjua një zhurmë dhe më vonë u dukën dy hije të zeza.

— Po vijnë, — i pëshpëriti Myzaferi shokut. — Do të veprojmë ashtu siç biseduam. Tani shtrihu barkas e mos lëviz.

Pas pak, dy shkelës dolën në breg, hoqën rrathët prej tape, i futën në çantat e shpinës dhe filluan të lëviznin me shumë kujdes, duke mbajtur largësi të caktuar me njëri-tjetrin. Kjo gjë e bënte të pamundur përfshirjen e të dyve brenda pritës së kufitarëve.

Diversantin që ecte i pari, njësitë e la të delte jashtë pritës dhe të futej në drejtim të thellësisë dhe u përqëndrua te i dyti, i cili duhej të ishte kryesori.

— Ndal! — i thirri atij me zë të prerë kufitari.

Diversanti zbrazti me shpejtësi një breshëri automatiku dhe menjëherë u kthye prapë në drejtim të lumit. Mirëpo nuk bëri më tepër se 6-7 hapa, kur dëgjoi një zë tjetër më të fortë përballë:

— Ndal!

Diversanti flaku granatën tymuese në drejtim të Myzaferit, doli te bregu i lumit dhe po bëhej gati të futej në shelgjishtat e dendura; ku tërë natën ta kërkoje, nuk e gjeje dot. Përgjegjësi i njësitit shkeli me shpejtësi për të tretën herë këmbëzën e automatikut dhe e rrokullisi spiunin pranë shelgut. Pastaj u hodh përpara, po në atë kohë, diversanti i plagosur e qëlloi dhe e la të vrarë.

Mbas pak forcat e dy postave kufitare rrethuen dhe likuiduan banditët diversantë. Por humbja e Myzaferit, i cili dha jetën një ditë para se të lirohej, i dëshpëroi pa masë shokët e tij. Megjithatë, kufitarët nuk e qanë Myzaferin, se trimat nuk qahen. Vepra e tij u mësoi ta duan më shumë kufirin, ta mbrojnë edhe me jetën atdheun. Ndërsa titistëve, Myzaferi, ashtu si shumë kufitarë të tjerë, u dha një mësim të mirë që para se të futen në tokën shqiptare, para se të prekin piramidat e Republikës sonë Popullore, duhet të mendohen mirë, pse për mbrojtjen e tokës amëtare është gati të japë edhe jetën po qe nevoja, jo vetëm kufitari, por i gjithë populli ynë.

Tani, kushdo që kalon te vendi ku u derdh gjaku i Myzafer Lipellarit, në bregun e Bunës plakë, qëndron me respekt të thellë para lapidarit të ngritur në kujtim të kufitar Myzafer Lipellarit, djalit trim nga Vloçishti, që dha jetën për të mbrojtur kufirin.

I PAMPOSHTUR

«Ju mbroni popullin, por bazën
dhe burimin e fuqisë suaj e keni
tek populli».

ENVER HOXHA

Një ditë më parë, njësitë kufitarë të postës bregdetare kishin zbuluar dy gjurmë.

Duke marrë parasysh se ditën në atë sektor kishin qarkulluar persona të ndryshëm, nuk mund të arrihej plotësisht në përfundim se gjurmët ishin të shkelësve të kufirit. Për këtë arsye u rikontrollua edhe një herë me imtësi bregdeti dhe atje, vështrimi i mprehtë i kufitarëve diktoi të mbuloheshin në rërë dy kostume noti, që përdoren për të kaluar nëpër ujë. Në vend u dërgua menjëherë grupi i kërkimit, bashkë me qenin, për të ndjekur gjurmët. Gjurmët shkonin treqind-katërqind metra dhe aty humbisnin.

Në zyrën e komandantit të postës së kufirit, kryetari i degës së punëve të brendshme, konsultohet me oficerët e kufirit.

— Shoku major — ju drejtua ai komandantit të repartit kufitar. — Çfarë mendoni ju në lidhje me situatën që na paraqitet?

Majori u ngrit dhe filloi të parashtronte mendimet e veta, qartë e shkurt:

— Të dhënat që kemi gjer tani në rrugë kufiri, gjurmët e zbuluara, kostumet e notit, tregojnë se kemi shkelje kufiri nga jashtë. Në lidhje me këtë situatë propozoj që ta mbyllim kufirin në bregdet, të ruajmë në mënyrë sekrete vendin e grososjes së kostumeve të notit dhe të ndiqet grupi i diversantëve.

Kryetari i degës, kur pa që edhe shokët e tjerë të grupit operativ ishin të një mendjeje me propozimin e majorit, aprovoi atë rrugë veprimesh e dha udhëzimet përkatëse për ruajtjen e përforcuar të kufirit, për kërkimin e shkelësve në thellësi, duke aktivizuar dhe grupet e bashkëpunimit vullnetar, anëtar i të cilëve ishte dhe Hekurani.

Biseda e Hekuranit me xha Hasanin ishte në përfundim e sipër, kur para tyre u dukën dy persona të veshur me rroba të banorëve të asaj krahine. Ata, pasi u përshëndetën me plakun dhe Hekuranin, kërkuan drejtimin e një fshati dhe vazhduan rrugën. Mirëpo ndërsa rrugëtarët u larguan nja dyqind metra, Hekuranit ju kujtua menjëherë e dhëna e degës së brendshme mbi personat e panjohur që ishin diktuar dhe dyshoi.

— More, i tha ai plakut, ata të dy që kaluan nuk më duken vendës. Janë veshur si fshatarë, por kanë mbathur këpucë.

— Dreqi e merr vesh.

— Dëgjo or babë, unë po shkoj t'i pyes nga vijnë, ku shkojnë dhe të bindem cilët janë ata.

— Bëj si të duash, unë do të pres këtu.

Hekurani u nis me të shpejtë në drejtim të

dy personave dhe, i arriti.

— Or miq, prej nga vini?

— Nga Luzi i Poshtëm.

— Po ku shkoni?

— Të thamë një herë se ku shkojmë.

— Po si vini nga Luzi, dhe nuk dini fshatin ku doni të shkoni?

Hekurani vuri re se të dy personat ndërruan fytyrë. Ai menjëherë u kërkoi dokumentat, por ata refuzuan t'ja jepnin duke i thënë, se nuk e njihnin dhe se Hekurani nuk përfaqësonte njeriun e ligjit.

— Ja kë përfaqësoj unë, u tha Hekurani duke u treguar dokumentin e degës së punëve të brendshme, me anën e të cilës vërtetohej se ishte pushkatar dhe pastaj u tregoi edhe armën që mbante. Atëhere njëri nga dy të panjohurit, duke e shikuar në sy shokun e tij, i tha:

— Si thua, t'ja japim dokumentat?

— Meqenëse është i degës, s'kam kundërshtim — u përgjegj i dyti.

Pas kësaj, i pari hodhi dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës, dhe, në vend të dokumentave identifikuese, nxori me shpejtësi pistoletën dhe e qëlloi tri herë Hekuranin në bark, në anën e djathtë. Hekurani, i plagosur rëndë, meqë ishte i fortë fizikisht dhe plagën e kishte ende të ngrohtë, ju hodh në grykë diversantit, e vuri poshtë, i mori pistoletën dhe, me armën e tij, e vrau. Pastaj filloi të qëllonte me pushkën e vet diversantin e dytë, i cili ishte larguar shumë. Hekurani e plagosi edhe atë, por nuk e ndoqi dot se kishte humbur shumë gjak.

Plaku, që kishte dëgjuar krismat e armëve, doli me të shpejtë në rrugën automobilistike, nda-



loi një maqinë dhe shkoi të njoftonte degën e punëve të brendshme.

Nuk kaloi më shumë se një orë dhe grupi operativ i degës, me forcat e policisë, arriti në vendin e ngjarjes. Pranë Hekuranit qëndronte doktori, i cili i bënte mjekimet e para, si dhe kryetari i degës.

— Të lumtë, Hekuran!

— I shërbej Republikës Popullore të Shqipërisë, shoku kryetar. Nisni me të shpejtë forcat. Diversanti i dytë është plagosur dhe do të jetë fshehur diku afër.

Pas pak, Hekuranin e nisën urgjent për në spital. Doktori i bëri një operacion të shpejtë e të mrekullueshëm dhe, ai u përmirësua shpejt, ndërsa diversanti i dytë, i plagosur në këmbë, u kap nga policia.

* * *

Ishte mesi i ditës. Kryetari i degës u ngrit nga karrigja dhe nisi të sodiste nga dritarja bulevardin dhe gjithë qytetin, i cili, ashtu si çdo qytet tjetër i vendit tonë, dukej si një kantier ndërtimi.

Çdo ditë ndërron fytyra e vendit tonë, çdo gjë tek ne është në rritje e në zhvillim, sepse të rinj jemi ne, e re është partia dhe pushteti ynë popullor, të reja, përparimtare janë idetë tona të socializmit e të komunizmit. Por e reja nuk del në skenë me lehtësi e pa vështirësi, po me djersë, me gjak e vështirësi, me shpatë në dorë me luftë me të vjetrën, e cila nuk tërhiqet vullnetarisht. Ja, edhe ajo që ndodhi dje, nuk është gjë tjetër

veçse një nga aspektet e luftës të së resë kundër së vjetrës. Përse janë dërguar ata?

Vendosi ta merrte në pyetje diversantin e kapur dhe urdhëroi kapitenin që, bashkë me të, të ngjitej lart.

— A mund të na i thuash në mënyrë përmbledhëse ato që ke deponuar? — i tha ai diversantit.

— Si urdhëron, zoti kryetar. Ne jemi nisur nga përtej detit një javë më parë, me një motobarkë, të maskuar si peshkatarë. Si ju afroam bregut shqiptar, barka u kthye. Në breg dolëm me kostume noti, të cilat i zhveshëm dhe i mbuam me rërë. Veshëm rroba fshatarësh dhe vazhduam rrugën për në thellësi. Pas tri ditësh u takuam me atë djaloshin dhe...

— Në vendin tonë djem të atillë ka me qindra dhe mijëra, është i gjithë populli, që ruan dhe vigjëlon veprën e tij. Po pa na thuaj me çfarë detyrash ju dërguan, dhe si do t'i realizonit ato?

— Të merrnim të dhëna me karakter ushtarako-ekonomik, të lidheshim me disa bazat tona, dhe t'i aktivizojmë ato në veprimtari armiqësore kundër Shqipërisë. Këto ishin detyrat tona.

— Po në rast se binit në përpjekje me forcat e Sigurimit dhe me forcat tona të kufirit dhe rrezikoheshit?

— Ne kishim udhëzime të bënim çmos për të mënjanuar përpjekjen me këto forca, prandaj edhe u munduam të mos linim gjurmë e t'i ndërlikojmë ato që të paralizojmë qentë e kufirit. Ne nuk duhej të binim të gjallë në dorë, dhe po të qe nevoja, do të përdornim ampulat helmuese.

— Po ti pse re i gjallë në duart tona? Nuk kishe mundësi të përdorje ampulën?

— Duke u fshehur te mullari me bar, mendova se shpëtova, meqë dhe plagën nuk e kisha të rëndë. Por humba ndjenjat.

— Sa kohë do të qëndronit në territorin tonë? Nga cili drejtim do të ktheheshit, dhe me çfarë mjeti?

— Në Shqipëri do të rrinim dhjetë ditë. Pastaj do të vinte të na merrte po ajo motobarka e peshkimit dhe në të njëjtën pikë ku zbarkuam. Në këtë rast mbetëm dakord që ajo t'i afrohej bregut deri në pesëqind metra, duke na dhënë me drita sinjalin. Në rast se do të bëhej i pamundur kthimi nga deti, kishim urdher të ktheheshim nëpërmjet Jugosllavisë ose Greqisë.

— Mirë, mjaft me kaq, — përfundoi kryetari.

Pasi mbaroi nga hetuesia, kryetari thirri në zyrë komandantin e kufirit dhe bënë së bashku planin për të kapur barkën që do të vinte më datën 10, për të marrë grupin e diversantëve.

* * *

Posta e kufirit kaloi përsëri në shërbim të përforcuar. Në sektorin e saj kryenin shërbim dy anije. Njëra e kufirit dhe tjetra anije siluruese e flotës luftarake-detare. E para ishte fshehur në derdhjen e lumit, ndërsa e dyta qëndronte në gatishmëri veprimi në një nga kepet bregdetare.

Ishte një natë pa hënë. Deti i qetë. Ora nuk kishte vajtur ende 22, kur anija siluruese, zbuloi në det diçka të zezë, që i afrohej bregut.

Me një manevrim të shpejtë, anija e flotës sonë luftarake i doli pas shpine, ndërsa anija e kufi-

rit doli papritur nga derdhja e lumit. Që të dyja e rrethuan motobarkën e huaj dhe kapën ekuipazhin që përbëhej prej tre personash.

Në fillim ata u munduan të legjendonin hyrjen e tyre brenda ujërave territoriale me zënjen e peshkut, por të nesërmen, kur u ballafaquan me diversantin e kapur, u zbërthyen menjëherë dhe treguan mbi aktivitetin e tyre subversiv kundër vendit tonë, si përcjellës diversantësh nëpërmjet detit.

* * *

Kaluan më se tri javë nga data e ndeshjes me diversantët, Hekurani, veshur me një kostum të mirë, po priste së bashku me kryetarin e uegës së punëve të brendshme në paradhomën e ministrit të punëve të brendshme.

Pas pak ra zilja. Sekretari i ftoi ata të dy që të hynin në zyrën e ministrit. Ata pasi u takuan me ministrin, zëvendësit e tij dhe anëtarët e tjerë të kolegjiut, zunë vend rreth një tavoline të gjatë. Mbas një çasti heshtjeje, ministri u ngrit dhe, me zërin e tij të ulët, por të mprehtë, ndër të tjera tha:

— Këtë mbledhje ceremoniale të kolegjiut e bëjmë për shokun Hekuran, për t'i dorëzuar dekoratën që i ka akorduar Presidiumi i Kuvendit Popullor: «Urdhërin e Trimërisë» dhe disa shpërblime të tjera në emër të Kolegjiut të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ne të gjithë jemi në dijeni për aktin patriotik e burrëror të Hekuranit, i cili u tha «ndal!» armiqve të popullit, duke mos kursyer as jetën.

Këto veprime të popullit tonë nuk janë as të parat dhe as të fundit, ato tregojnë se kufirin dhe rendin tonë, në përgjithësi, nuk e ruajnë vetëm organet e sigurimit, të policisë e të kufirit, dhe nuk e mbrojnë vetëm forcat tona të armatosura, por e ruan dhe e mbron gjithë populli ynë, se armikun e pret plumbi kokës jo vetëm në kufi, por edhe në thellësi. Akti i Hekuranit tregon se ai nuk i harron porositë e partisë dhe të qeverisë, se ushtari edhe në lirim është ushtar. Ata duhet të jenë gjithmonë vigjilentë e të gatshëm në çdo rast.

Pas kësaj, në gjoksin e Hekuranit shkëlqeu «Urdhëri i trimërisë».

«Me të tillë djem xhevahirë, — tha ministri, duke e përcjellë Hekuranin me sy — mund të bëhen mrekullira».

HOTELI I GJAHTARËVE

«Të dish të ruash kufirin, të gjurmosh, të zbulosh dhe të neutralizosh armikun, është si të thuash një art më vete. Këtë art mund dhe duhet ta përvetësojë më së miri, çdo njeri që i thotë vetes kufitar i vërtetë»

ENVER HOXHA

Dielli i korrikut digjte më shumë se çdo herë tjetër. Qyteti i vogël bregdetar grek nuk kishte gjallëri të madhe, me përjashtim të plazhit, dhe qendrës të zbulimit e të korofillaqisë. Në atë godinë hynin e dilnin pa pushim ushtarakë e civilë.

Shefi i ASFALI-së, një burrë mbi të pesëdhjetat, me spaleta nënkoloneli mbi supe, ishte ulur në poltron dhe po lexonte diçka në dosjen, që kishte përpara, në tavolinë. Pas pak në zyrë hyri një oficer me mustaqe të zeza e të prera spic, që ai vetë e kishte thirrur pak më parë, ishte shefi që drejtonte hedhjen e grupeve diversante në Shqipëri.

— E, zoti kapiten, ç'bëni me grupin «B»? — e pyeti nënkoloneli.

— Sot përfunduar përgatitjet dhe së shpejti do ta nisim — ju përgjegj kapiteni.

— Si shumë u zgjat përgatitja e tyre! Grupi ka mjaft eksperiencë dhe terrenin shqiptar e njeh pëllëmbë për pëllëmbë.

— Ashtu është, zoti nënkolonel, por edhe ata andej nuk e hanë thatë.

— Ose ju kapiten, nënvleftësoni veten tuaj, ose mbivlerësoni shqiptarët. E dyta është edhe më e keqe, sepse ka të bëjë me gjënë më kryesore në punën tonë, me moralin e grupit.

— Më falni, nuk më kuptuat. Siç jeni në dijeni, kohët e fundit shqiptarët e kanë forcuar kufirin dhe kjo mua më shqetëson. Sa më mirë të përgatitemi, aq më i sigurtë do të jetë sukcesi.

— Sa herë janë futur dhe kthyer shëndoshë e mirë këta bandillë!

— Po, por njëri mbeti pa krah nga plumbat e rojeve shqiptare, ndërsa tjetri është rrezikuar dy herë.

— Në fund të fundit, përse i kemi, «Manastiri shëndoshë se kallogjerë gjen». Më thuaj tani, kur do të nisen dhe kush do t'i shoqërojë deri në kufi.

— Do t'i shoqëroj vetë. Pasnesër dalim nga qyteti. Do të qëndrojmë dy ditë në pikën tonë të avancuar «Hoteli i gjahtarëve», ndërsa ditën e tretë, grupi do të kalojë kufirin te Qafa e Minave.

— Mirë, shumë mirë. Më njoftoni kalimin e kufirit nga grupi. Tani hajde ta kthejmë nga një gotë!

Kapiteni e përpoqi me shefin dhe e ktheu gotën menjëherë. Pastaj, me hap të shtrirë, doli nga

zyra. Megjithëse nuk u ndie për ato që tha ep-
rori, me vete ziente.

— Si rregull, mosha mbi të pesëdhjetat, ësh-
të koha e shpërthimeve të talentit dhe eksperien-
cës së akumuluar, por te shefi im ndodhi e kund-
ërta, — tha me vete kapiteni. Në vend që të
më përgëzojë për punën e hollë, të rafinuar dhe
të kujdesshme, e quan betejën të fituar pa e fi-
lluar. Kësaj i thonë ta shesësh lëkurën e ariut
para se ta kesh vrarë.

* * *

Mbrëmje. Në një nga qoshet e ndara me perde
të pijetores, dy persona përpiqnin gotat e rakisë.

— Brompt Drizo, të pimë për rrugën tonë të
mbarë, megjithëse këtë radhë, nuk e di pse, kam
parandjenja të këqia.

— Për parandjenjat e tua nuk bëhem merak.
Tërr s'ma bën syri, ku rafsha mos u vrafsha, dy
duar për një kokë, prandaj të pimë dhe bile me
fund! — u përgjegj Zerua.

— Ashtu thamë edhe herën e parë, por e pe
si e pësua tek Qafa e Çengelit, sikur të mos
i qe blokuar automatiku, rreshteri ma këndoi
ungjillin.

— Pse e bën djallin më të tmerrshëm nga
ç'është. Do të gjejmë një shtek nga të futemi.
Duhet të kemi kujdes në brezin e butë e te
gardhi me thupra të thata, që sa ta shkelësh,
kërcet si pisqollë prej tape.

— Hajde Drizo, hajde! Ti fillove të më ja-
pësh kurajo, por të hyri tartakuti që këtu në

restorant. Dhe nga kush, nga gardhi? Por ata nuk kanë vetëm gardh dhe brez gjurmësh.

— Ne, or mik, e pësuam si ajo që tha: «Keq me burrë e keq pa burrë, keq dhe pa martuar kurrrë». Por më në fund u martua, se s'kishte si të bënte ndryshe. Prandaj edhe ne ta mbajmë mirë burrin. Hidhe edhe një herë me fund, se mbase na shkon mbarë.

— Ki kujdes se mos e lësh këtë radhë fare krahun e thyer!

— Këtu bëhet fjalë për radaken e ti ke frikë për krahun. Ç'të bësh, kështu e kanë këto punë. «Po s'lëvize këmbët, nuk i luan dhëmbët».

— Çfarë pune është kjo jona, me kokë në trastë! A e mban mend kur u arratisëm nga Shqipëria? Kujtuam se këtu do të gjejmë fushë me lule, ndërsa na doli ndryshe. Me të kaluar kufirin, grekët na çuan në Janinë dhe pastaj filloi avazi: hetuesi mbas hetuesie, kurrizin na e bënë më të butë se barkun. Edhe me gurë, si gomarin, na ngarkuan. Lëri pastaj kampet e përqëndrimit, që i kemi ndërruar si mbreti gratë.

— E di, pse na e punuan kështu? Dyshonin se mos na kishin hedhur shqiptarët si agjentë! Dhe vërtet, të gjithëve s'ju besojmë dot! Por nuk është vetëm kjo. Këta na trajtuan keq, që, kur të na propozonin për të hyrë në shërbim të tyre, të tregoheshim të gatshëm. Ohu, sa ka zanati or mik!

— Edhe ne u kemi shërbyer që ç'ke me të. Sa herë jemi bërë fidainjë për këta. E kemi hallall bukën, po qoke këtu!

Kufiri shtetëror, në këto anë kalon kurri-zeve malore-kodrinore, nëpër qafa të mbuluara me pisha e drunj ahu të rreshtuar sikur t'i ketë vënë dora e njeriut. Në një nga faqet veriore të këtyre kodrave është vendosur posta kufitare.

Reth orës 14, në rrugën automobilistike karshi postës, u duk një maqinë gaz-veturë. Ishte e komandantit të repartit kufitar. Pas pak, maqina arriti në postë, ku zbriti një burrë me trup mesatar e shpatullgjerë, që nuk tregonte më tepër se dyzet vjet.

— Shoku komandant! Nga sektori i postës kufitare «N» ka të reja. Komandanti i postës, Guri!

— Qetësohu, qetësohu, si je shoku Guri, si janë kufitarët?

— Mirë, falemnderit, Kufitarët, me përjash-tim të atyre që janë me shërbim, bëjnë pushimin e drekës.

— Shumë mirë! Gjumi në drekë, për kufi-tarin, është gjë e madhe. I çlodhur, ai natën mund të vigjëlojë me orë të tëra. Po të rejat nga i kemi dhe çfarë janë?

— Nga vrojtimi, shoku komandant.

— A ha, nga vrojtimi. Po ushtarët kur ngrihen?

— Pas dy orësh janë gati.

— Atëhere, na udhëhiqni për vrojtim. Atje bisedojmë mbi të rejat që kemi.

Pas një pushimi të shkurtër në «Hotelin e gjahtarëve» grupi i diversantëve, i udhëhequr nga kapiteni, doli te pika nga do të kryente zbulimin në drejtim të territorit tonë. Tri orë kaluan me përcaktimin e vendit të kalimit, me mënyrën e afrimit në vijën e kufirit dhe me itenerarin e lëvizjes. Në vazhdim të rikonjcionit, kapiteni përfundoi.


— E shikoni Qafën e Minave? Ajo mund të kalohet më lehtë. Ditën nuk sigurohet, ka mina, por ato janë të vjetëruara. Veç kësaj, me vrojtim, këtë qafë nuk e mbajnë dot nën kontroll. Kur të delni në vijën e kufirit, futuni në pyll dhe, me të rënë mirë errësira, vazhdoni rrugën në thellësi. Në vendet ku dyshoni se mund të ndesheni me pritrat, ndaloni, përgjoni me kujdes. Kështu mund të zbuloni në se ka gjë përpara. Me kaq, rikonjicioni mori fund. Ka ndonjë pyetje? Qartë? Atëhere gati për veprim.

Në pikën e vrojtimit, komandanti sqaroi se në mëngjez herët në «Hotelin e gjahtarëve» kishte ndaluar një «xhips» amerikan dhe prej tij kishin zbritur 3 persona.

— Sot, shoku komandant, vërtetua edhe një herë atë që na është thënë se armiku përdor nënyra dhe metoda të rafinuara kalimi. E dini se ku kishin dalë për vrojtim? Te «Shkëmbi i Qyqes», në një kaçube që nuk e vrojtonte dot një-siti ynë i zbuluar.

— Po në ç'mënyrë i zbuluat?

— Njësitë ynë sekret vrojtonte me vëmendje sektorin që i ishte ngarkuar, kur te kaçubja erdhi një zog i madh, që sa u ul, u ngrit menjëherë. Kufitarët dyshuan shumë nga kjo gjë dhe



e përqëndruan atje vrojtimin. Rreth orës 10 ata zbuluan të tre personat që u larguan nga vendi i vëzhgimit.

— Ju lumtë shokë, kështu duhet të arësyetojnë në kufitarët tanë. Ne duhet ta organizojmë shërbimin për ruajtjen e kufirit jo në mënyrë shabllone, por në përshtatje me format dhe metodat që përdorin shkelësit e kufirit. Ju keni menduar drejt.

* * *

Kufitarët ishin ngritur nga gjumi i drekës dhe po rregullonin krevatet. Kuzhinieri që kishte vënë gjellën e darkës, shikonte nga dritarja instruktorin, që kishte nxjerrë qenin nga kalibja dhe bënte me të shëtitjen. Pas pak, roja e postës, duke soditur me dylbi sektorin e ngarkuar për të ruajtur, zbuloi se grupi i oficerëve, me në krye komandantin e repartit, po kthehej nga pika e vrojtimit.

Komandanti dhe grupi i oficerëve erdhën te kufitarët dhe së bashku me ta u ulën në stolet e tendës verore dhe filluan të bisedonin përzemërsisht me njëri-tjetrin. Ai i pyeti në kishin marrë letra nga prindërit dhe ç'u shkruanin ata.

— Po, unë kam marrë — tha Nazmiu, një ushtar nga Peshkopia. Ata më shkruajnë se sivjet kanë siguruar të ardhura të mira nga bujqësia. Veç kësaj ata më shkruajnë edhe për një gjë që më ka gëzuar shumë: plaku im paska marrë pjesë në kapjen e dy shkelësve të kufirit dhe për këtë edhe e kanë dekoruar.

— Nuk është çudi të të jepet edhe ty ndonjë rast i tillë. Po shkelësit duhet t'i kërkosh, se ata

u largohen kufitarëve si djalli thimjamit. Po si t'i kërkojmë e t'i zbulojmë? Duke dyshuar e nxjerrë konkluzione për çdo gjë të parandësishme në dukje. Dhe për t'i kërkuar e gjetur shkelësit — vazhdoi komandanti — duhet të jesh edhe gjurmues i mirë. Po, nuk është vetëm kjo kërkesa kryesore për kufitarin. Ka dhe shumë të tjera. Ja, p.sh. me disiplinën si është posta? — ju drejtua ai sekretarit të organizatës së rinisë.

— Mirë është, shoku komandant.

— Disiplina është ligj themelor për ushtritë në përgjithësi, ndërsa për ushtrinë revolucionare e popullore, siç është jona, ligj themelor është disiplina e ndërgjegjshme. Pa një disiplinë të tillë, as që mund të bëhet fjalë për ruajtjen dhe mbrojtjen e kufirit. Mirë! Unë, si kufitar i vjetër, interesohem dhe për një çështje tjetër, për qenin e postës. Si e keni, si e quajnë dhe kush është instruktori i tij.

— Unë jam, shoku komandant. Qeni nuk është i keq. E quajnë «Shqiponjë» dhe e ndjek gjurmën në largësi të madhe, u përgjegj një kufitar.

Komandanti i hodhi një sy dashamirës prej prindi efektivit të postës dhe, e mbylli bisedën e tij të shkurtër. Ai krijoi përshtypjen se kishte të bënte me një kolektiv ushtarak të zjarrtë e monolit, i cili po të paraqitej nevoja, mund të përsëriste pikë për pikë, në mos edhe më mirë, veprën heroike të shumë kufitarëve paraardhës, eposenë e 36-ve, të Tafil Ferhatit, Hajdar Tafës, të Myzafer Lipellarit e të pesë dëshmorëve të lumit të Gashtit, etj. Komandanti u përçafua një për një me këta sokola dhe u largua nga posta e kufirit.

Vrojtuësit kishin gati 30 minuta që ishin larguar nga vendi i shërbimit të ditës. Ata qenë vendosur në një shteg 300-400 m. më tej pikës së vrojtimit dhe përgjonin me vëmendje të madhe. Edhe njësi i kontrollit, i kryesuar nga kujdestari i postës, nuk kishte shumë që ishte larguar nga ai sektor.

Aty rreth orës 9, u dëgjua një zhurmë e vogël dhe pas pak rrokullisja e dy gurëve njëri pas tjetrit. Kufitarët u ngjitën me tokën dhe nuk bënë asnjë lëvizje. Nuk u gabuan. Para tyre u dukën dy hije të zeza që po afroheshin.

— Ndal! Duart lart! — u dëgjua një zë i fortë dhe i prerë, të cilin e pasoi dueli i armëve. Diversantët hapën zjarr dhe u larguan. Kufitarët ndriçuan vendin me raketa për të përcaktuar drejtimin e largimit të shkelësve dhe për të dhënë sinjalin në postë. Pastaj ju qepën prapë banditëve.

Edhe njësi i kontrollit, me të dëgjuar sinjalin, u nis menjëherë për në vendin e ngjarjes, u ndesh rrugës me diversantët, por pa rezultat.

Banditët, të tronditur e të lodhur, ishin futur në një zgavër dhe po mendonin për veprimet e mëtejshme:

— Plani ynë dështoi, — tha njëri prej tyre. Me bazën në këto kondita, është e pamundur të marrim kontakt. Forcat komuniste po na kërkojnë. Megjithatë, duhet të veprojmë pa humbur kohë, të bëjmë çmos të këputim kontaktin, duke synuar që të këthehemi mbrapa.

— Por kufiri është mbyllur, a e kalojmë dot?

— Pse vetëm kufiri? Tanimë është i rrethuar i gjithë ky rajon. Nesër prit forcat e kërkimit me qentë e kufirit, që të gjejnë edhe sikur të fshihesh në bri të buallit. Pastaj, edhe në rast se ndeshemi në afërsi të kufirit, kemi shpresë të shpëtojmë vetëm duke shpërthyer me zjarr. Ndërsa po të shkojmë në drejtim të thellësisë, do të na duhet të bëjmë disa shpërthime e në mos në një rën, në tjetrën do të na zënë të gjallë, ose do të lëmë lëkurën. Veç kësaj, po të ndeshemi në afërsi të kufirit, kemi shpresë të mbështetemi me zjarr nga rojet kufitare greke.

Po afrohej mëngjezi. Diversantët lëviznin me shpejtësi në drejtim të kufirit. Por, jo më larg se një kilometër nga ai, u ndeshën përsëri me kufitarët. Si hapën zjarr me automatikë dhe flakën nga një granatë, morën në drejtime të ndryshme, duke u ndarë më dysh. Përgjegjësi i njësitit ju qep prapa njërit prej diversantëve, ndërsa të dy kufitarët e tjerë ndoqën diversantin e dytë. Me sinjalin e njësitit kufitar; «rashë në përpjekje», u ngritën në këmbë jo vetëm kufitarët, por edhe banorët e katundeve të zonës kufitare, të cilët pjesërisht mbyllën drejtimet e rëndësishme në thellësi, duke krijuar kështu vijën e dytë të rrethimit.

Ndërkaq zbardhi dita. Zerua përpiquej me çdo kush të shpëtonte lëkurën, por edhe kufitari nuk i ndahej. Ai donte ta kapte të gjallë, se diversanti nuk ishte më larg se 50 metra dhe mundohej të kalonte një gardh teli. Ai mendonte se pas gardhit, fillonte menjëherë toka greke. Kur u mat të kapërcente përtej, kufitari shkeli këmbëzën e automati-

kut dhe e palosi mbi gardh. Në atë kohë arriti grupi i alarmit dhe nga kontrolli i kufomës u konstatua se plumbi i kufitarit e kishte goditur mu në zemër. Bashkë me të, kishte shpuar tejpertej edhe një nga stërlinat, për të cilat ai la kokën.

Diversanti tjetër pasi u nda nga shokët, u fut në një ferrë që të çlodhej pak dhe, pastaj, si të qetësohej puna, të largohej pa u diktuar.

Mirëpo, mbas pak u duk para tij grupi i kufitarëve i ardhur nga posta, bashkë me «Shqiponjën». Drizua, kur e pa pisk vendosi të largohej me shpejtësi në drejtim të Gropës së Derrave. Por qeni ja prishi planin. Për të shpëtuar nga qeni ai nxori biçakun nga gëzofi dhe ja flaku «Shqiponjës». Diversanti mundi të largohej edhe disa hapa por ju qep prapa instruktori i qenit.

— Ndal se do të shtie!

— Diversanti s'ja vuri veshin paralajmërimit.

— Instruktori e qëlloi me pistoletë, e plagosi në krahun e djathë dhe e detyroi të strukej në një shpellë. Instruktori duke përfituar nga rasti, e çliroi qenin nga biçaku. «Shqiponja», e egërsuar, ju turr Drizos në shpellë dhe e kapi në kofshë. Por shpejt ra i ngordhur nga predhat e diversantit.

Pas kësaj ngjarjeje, zjarri u ndalua. Të dyja palët kishin mbetur pa fishekë. Diversanti e kuptoi këtë. Doli nga shpella dhe me thikë në dorë, ju turr instruktorit.

— E, ku do të vesh tani, do të të marr shpirtin!

— Afrohu po ta mbajti! Ty të dridhen duart. Diversanti u turr për ta goditur, por kufitari me një manevrim të përsosur ja flaku thikën nga

duart. Arma ra afër diversantit që mundi ta marrë dhe t'i turrej përsëri kufitarit. Në atë çast arriti një nga kufitarët e tjerë me kryetarin e kooperativës. Ky i fundit, me shpejtësi dhe përpikmëri, e goditi banditin dhe e la të vdekur para këmbëve të instruktorit. Ai i shtrëngoi dorën shokut dhe u turr me shpejtësi për tek qeni i vranë.

Mbas dy ditësh një telegram nga qendra përgëzoi gjithë efektivin që mori pjesë në veprim. Në të njëjtën kohë, sinjalizohej se grupe të tjera diversantësh priteshin të vinin. Midis tyre, një grup kryesohej nga një kuadër me përyojë i zbulimit grek. Koha dhe vendi i hedhjes së këtij grupi, nuk jepej.

* * *

Shefi i ASFALI-së, i shqetësuar, qëndronte i kërrusur mbi tavolinë dhe lexonte informatën mbi likuidimin e grupit «B». Më tej, në një kolltuk, ishte ulur dhe lexonte gazetën në mënyrë indifereente një kolonel amerikan.

— Si mendoni, zoti kolonel, kë të dërgojmë për lidhjet me atë anë? Ata presin udhëzimet tona.

— Këtë radhë duhet të nisni një grup të mirë, të sigurtë, të pregatitur dhe me autoritet, d.m.th. personalitete të zbulimit tonë, sepse edhe njerëzit me të cilët do të takohen, janë të tillë. Grupi do të ngarkohet me një mision shumë të rëndësishëm. Prandaj ta mendojmë mirë.

Në zyrë hyri kapiteni i vrenjtur dhe i rënë moralisht nga dështimi i fundit. Në dorë mbante dy dosje me të dhënat e kandidatëve që do të hidheshin në Shqipëri.

— Nuk më duhen dosjet, — ja preu ftohtë shefi, asnjë nga këta nuk është i përshtatshëm për të realizuar detyrat që duhet të zbatohen në tokën shqiptare. Prandaj, i lini dosjet në tavolinë dhe uluni. Për këtë kalesë ne duhet të kemi shumë kujdes, sepse ka lidhje me një nga fijet e rëndësishme të zbulimit tonë, e cila fillon që nga vija e kufirit dhe shkon deri në Tiranë. Po na u zbulua dhe na u këput ky fill, na dështon një punë 15-vjeçare.

— Ashtu është! — ndërhyri amerikani, qendra interesohet në mënyrë të veçantë për këtë kalesë. Unë jam dakord me konkluzionet tuaja dhe mendoj që të merremi konkretisht me personat që do të dërgojmë. Ja p.sh. unë mendoj se kandidati më i mirë për drejtimin e këtij grupi do të ishte vetë kapiteni. Është me origjinë shqiptare dhe ka një barrë me eksperiencë. Pastaj, është futur disa herë në Shqipëri dhe vendin e njeh me pëllëmbë.

— Ma morët nga goja, kolonel! Do të rroni më shumë, — ju përgjegj shefi i ASFALI-së.

Kapitenit i ra njoftimi si bombë, por e mbajti veten dhe me zë të ulët e të qetë pranoi propozimin. Në përbërjen e grupit u përfshinë edhe dy kuadro të rëndësishëm të zbulimit grek.

Festë e bukur është përcjellja e vitit të vjetër dhe pritja e vitit të ri. Por kufitarët, në ditë të tilla janë më të mobilizuar e tregojnë më tepër kujdes, sepse edhe armiqtë këto ditë i shfrytëzojnë. Prandaj posta e kufirit një natë para Vitit të ri kishte kaluar në shërbim të përforcuar. Ko-

misari dhe punëtori operativ i postës po bisedonin rreth të dhënës që kishin për kalimin e kufirit.

— Ashtu si e kemi organizuar shërbimin, vështirë të mos ndeshemi me ta, — i tha komisarari punëtorit operativ.

— Ashtu them dhe unë, por më ha merakun për një gjë: që t'i zëmë të gjallë.

— Ke plotësisht të drejtë komisar, por e di çfarë? Nuk e lëmë komandantin të çlodhet dhe shkojmë të shikojmë njësitet ç'bëjnë, a kanë të ftohtë, ë?..

— Ngrihemi, — tha tjetri dhe u nisën pa vonesë.

Viti i ri kishte më se një orë që kishte ardhur. Një re shiu po kalonte nga ato anë. Era ulërinte.

Nëpër suferinë kufitarët vazhdonin të kryenin shërbimin. Gjatë disa orëve ata s'kishin parë e dëgjuar gjë. Vetëm aty nga mesi i natës, në mbarim të shërbimit, ata dëgjuan një zhurmë të mbytur hapash.

— Ç'të jetë? Shkelës apo kontroll nga posta, — pyetën ata njëri-tjetrin.

Kufitarët lanë mushamatë në vend për të mos u ndjerë dhe lëvizën me kujdes në drejtim të zhurmës, herë të përkulur dhe herë barkas, në ujë e baltë. Ata u lagën e u përbaltën me përjashtim vetëm të pushkëve që i mbanin të ngriatura lart. Errësira e thellë e natës i pengonte edhe më shumë për të lëvizur. Vetëm në çastet kur rrufetë çanin errësirën, ata hidhnin disa hapa përpara e përsëri qëndronin në përgjim. Në një nga këto çaste dhe pikërisht në çastin kur në të

katër anët e atdheut jehonin këngët e gëzuara rreth tryezave të mbushura plot, njësi diktoi dy hije të zeza që vinin gjithnjë duke u afruar.

Kufitarët, të gëzuar se më në fund po u vinte gjahu në shteg, zunë vend dhe pritën. Por ç'të shihnin: Ishte kontrolli i postës me në krye punëtorin operativ të zbulimit! Njësi i raportoi punëtorit operativ se ç'kishte dëgjuar pak më parë. Punëtori operativ aty për aty nxori përfundimin se këtu kishte diçka të dyshimtë, prandaj ai e urdhëroi njësitin kufitar të kthehej në vendin e shërbimit të mëparshëm, ndërsa vetë, me shoqëruesin, u nis për një postë për të dërguar në vendin e ngjarjes grupin e kërkimit me qenin si dhe për të marrë edhe disa masa të tjera në rrugë sigurimi.


* * *

Kishte filluar të dilte mirë drita. Grupi i kërkimit me qenin kishte rënë në gjurmë dhe vazhdonte ndjekjen. Oficeri që udhëhiqte kërkimin manevronte mirë dhe nuk i ndahej gjurmës. Aty rreth orës 6 të mëngjezit, kur ai i ishte afruar katundit, mori urdhër që të ndërpriste ndjekjen e gjurmës dhe përkohësisht grupi të kalonte në blokimin e vijës ku ndodhej.

Ç'kishte ndodhur? Zhurma që kishte dëgjuar natën njësi dhe gjurmët e zbuluara në kufi, ishin plotësuar me të dhëna në rrugë sigurimi, sipas të cilave, një grup diversantësh, i përbërë nga tre veta, që futur në territorin tonë në mbrëmjen e asaj dite dhe tani ishte fshehur në një guvë në veri të katundit. Te guva, bashkë me diversantët,

ndodhej edhe tezja e njërit prej tyre, e cila ishte thirrur që t'u shërbente si ndërlidhëse e grupit.

Komanda e repartit të kufirit, duke patur të dhëna për dukjen e grupit të diversantëve dhe



për rëndësinë e tij, vendosi që me shpejtësi të madhe e në fshehtësi të rrethonte guvën dhe pastaj, me forca të tjera të bëhej kapja ose asgjësimi i diversantëve. Ishte kjo arësveja që kërkimi mbas gjurmës u ndërpre para blokimit të vendit ku ndodheshin diversantët. Ndryshe ata me të diktuar se po ndiqeshin këmba-këmbës, do të përpiqeshin të largoheshin ose të ktheheshin mbra-pa, gjë që do të vështirësonte më shumë kapjen e tyre.

Aty nga ora 10, ishin marrë të gjitha masat. Në fillim u mbyll me shpejtësi kufiri, pastaj, me forca të tjera u rrethua i gjithë rajoni. Diversantëve ju bë thirrje që të dorëzoheshin, por ata nuk u përgjegjën as me zjarr as me gojë. Atëhere forcat e kërkimit u drejtuan për në guvë. Përgjegjësi i grupit të diversantëve u ngrit të shpërthente me zjarr rrethimin. Pas tij u ngritën edhe diversantët e tjerë. Por kur panë që shkëmbi ishte i rrethuar nga të katër anët dhe forcat e kufirit ishin ngritur nga pozicionet e po turreshin nga shumë drejtime, u kthyen në guvë.

Grupet e kërkimit u turrën mbi guvë nga ana e sipërme e saj dhe mbyllën kështu çdo dalje të mundshme për diversantët. Ata u bënë thirrje diversantëve të dorëzoheshin se përndryshe do t'u hidhnin granatat dhe do të lëshonin qentë.

Atë çast, banditët u gjunjëzuan. Një leckë e bardhë u zgjat që nga brenda te dalja e guvës e pas pak hijet e natës dolën në dritën e diellit që ndriçonte tokën tonë amëtare.

NJERIU ME BORSALINO

«Gazi», që shpinte në Veri një grup oficerësh të kufirit, po u ngjitej të përpjetave të Qafës së Malit. Përpara ishte ulur shefi, ndërsa në vendet e prapme rrinin tre oficerë të tjerë, dy prej tyre ishin të rinj, ndërsa i treti ishte një trashalug, që merrte frymë me shpatulla, me mustaqe të prera shkurt dhe gati të thinjura.

— Siç duket, u lodhët, — u tha shefi atyre kur pa se ata po heshtnin — Keni të drejtë, ju ende s'jeni mësuar me udhëtime të gjata. Veç kësaj, aty, në vendet e prasme, tronditja ndjehet më shumë.

— Jemi dhe ca shtrënguar, — ndërhyri oficer Brahua, ai më trashalugji.

— Petriti nuk mërzitet aq nga rruga e gjatë dhe shtrëngimi sa nga maqina që e zë, — tha Guri njëri nga oficerët e rinj.

— Përse nuk thatë që më parë t'i kishim lëshuar vendin këtu përbri shoferit.

— Nuk e vlen të shqetësoheni, shoku shef, sepse Guri e tepron. Vetëm në kthesa e kam ca vështirë, por po të vazhdojmë kështu si kemi udhëtuar deri këtu, me shakara, biseda e tregime nga të luftës, nuk kam për ta ndjerë fare lodhjen.

— Mirë e ke ti, or trim, por unë nuk jam thes mielli, që sa herë t'i biesh, nxjerr pluhur. Tregimet nuk janë pa fund.

— Në rast se nuk ju kujtohen ngjarje nga të luftës, mund të na tregoni ngjarje nga të kufirit, nga të cilat ju dini shumë.

— Po, për kufirin mund të tregoj ndonjë ngjarje.

* * *

— Ngjarja, — filloi shefi, — ka ndodhur në vitin 1957, në një nga postat kufitare. Në atë kohë Hrushovi dhe grupi i tij revizionist kishin flakur vendimet e drejta dhe shpëtimtare të Informbyrosë për përjashtimin e klikës së Titos nga lëvizja komuniste dhe kishte shkuar në Beograd për t'i marrë dorën kreut të kësaj klike e për ta riabilituar atë.

Në këtë kohë UDB-ja jugosllave, po përdorte forma e metoda më të holla për ushtrimin e veprimtarisë së saj armiqësore ndaj vendit tonë. Ajo shfrytëzonte kanale të tjera më pak të shfrytëzuara e më pak të komprometuara.

Në këto kushte organeve e reparteve të MP të Brendshme u delte detyrë të përsosnin më tej shërbimin për të kundërvepruar me sukses.

* * *

Ishte mbasdite qershori, por lartësia mbi nivelin e detit dhe natyra malore e krahinës ndikonin që pranvera të qëndronte ende.

Në zyrën e postës, komandanti ishte duke men-

duar mbi mënyrën e organizimit të shërbimit për ruajtjen e kufirit në 24-orëshin e ardhshëm. Ndërsa ngjitur me godinën e postës, rreth saj, majtas e djathtas dhe në afërsi të sektorit kufitar që ajo siguronte, ziente puna bujqësore. Një grup i madh kooperativistësh pastronte barërat në arat e gjelbëra, një grup tjetër prishte gardhet e ish-parcelave private, traktori çante tejpërtej një tokë të zezë. Matanë kufirit, megjithëse tokat nuk janë më të këqia nga tonat, parcelat individuale, të ndara e të papunuara, ishin të shkreta.

Në çastin kur njëri nga vrojtuesit ishte duke bërë një krahasim të tillë, kapi me dylbi një «xhips» amerikan që vinte nga thellësia e tokës jugosllave në drejtim të kufirit. Komandanti i postës u ngjit menjëherë te vrojtuesit dhe filloi të vëzhgonte me dylbi. Pas dhjetë minutash maqina arriti në postën jugosllave. Nga ajo zbritën katër veta — tre oficerë dhe një civil me borsalino.

— Maqina është amerikane, — u tha shokëve me zë të ulët njëri nga vrojtuesit.

— Jo vetëm maqinën, por edhe mendimet në kokë i kanë amerikane, — ju përgjegj përgjegjësi i njësitit.

Grupi i oficerëve jugosllavë dhe «intelektuali» dolën në vijën e kufirit përkundrejt postës së tyre, bënë me dorë për nga thellësia e tokës së tyre që të mos krijonin dyshime dhe, pas gjysmë ore, u larguan nga erdhën. Ndërsa komandanti i postës sonë, së bashku me punëtorin politik, që e kishte mbaruar bisedën me ushtarët, filluan nga diskutimi mbi ardhjen e «xhipsit» amerikan dhe për vlerësimin e këtij veprimi në ruajtjen e kufirit.

— Ç'eshtë ky xhips me oficerë dhe me një njeri me borsalino, që vjen në këtë kohë e largohet shpejt e shpejt? — e pyeti komandanti punëtorin politik dhe, pasi i ra lehtë tavolinës me fundin e stilografit, u ngrit e doli në dritare dhe drejtoi sytë nga lumi, sikur t'i kërkonte atij përgjegjen.

Në këtë çast ra dhe zilja e telefonit. Vrojtuesi njoftoi se nga kulla jugosllave e vrojtimit, në të cilën kryente shërbim një ushtar, tani dy-tre ushtarakë vrojtonin me dylbi në drejtim të territorit tonë, e veçanërisht vëmendjen e kishin përqëndruar në Luginën e Qyqes. Ata nuk linin përshtypjen se ishin ushtarë të postës. Komandanti, pasi kërkoi nga vrojtuesit të forconin vëzhgimin dhe për çdo të re të raportonin, u ngrit në këmbë dhe i tha punëtorit politik: «Sonte nata e mbarsur me të papritura mund të pjellë.» Pas kësaj, të dy vendosën të mos shpejtoheshin, por ta analizonin mirë situatën, të nxirrnin konkluzione të bazuara, të merrnin masa të përshtatshme për sigurimin e kufirit dhe të informonin për to komandën eprorë.

I pari e mori fjalën punëtori politik, i cili parashtrroi një sërë versionesh.

— Përse e kanë forcuar vrojtimin dhe ku? Vetëm në sektorin tonë?

Për të verifikuar dyshimet e veta ai mori në telefon postat tona të krahëve, por ata u përgjigjën se nuk kishin vënë re gjë në sektorët e tyre.

Rreth këtyre çështjeve ishte përqëndruar edhe mendimi i komandantit, i cili, pasi bëri disa lëvizje të shkurtëra në dhomën e shtruar me çimento, u drejtua nga bashkëpunëtori i tij, i vuri dorën në

supin e majtë dhe i tha se kishte arritur, përafër-
isht, në këtë përfundim:

— Ardhja e «xhipsit» me oficerin e civilin duhet të jetë e lidhur me pregatitjen për kalesë kufiri. Kjo gjë mund të pritët sonte ose nesër mbrëma, në drejtimin Lugina e Qyqes, si drejtim më i mundshëm dhe më i shkurtër për tu futur në thellësi. Për këtë gjë jugosllavët bënë një demonstracion të tërë. Ata ndërruan rrobat e civilit me rrobat e ndonjë ushtari të postës së tyre, me qëllim që të krijojnë përshtypje se ata persona që erdhën, u kthyen dhe se, në postën e tyre nuk mbe-
ti njeri nga të ardhurit.

— Sipas jush civili që u largua, nuk ishte ai që erdhi. Vetëm rrobat do të kenë qenë të tij,
— ndërhyri punëtori politik i postës.

— Po, dyshoj për një kombinacion të tillë. Një palë rroba i kanë përdorur dy persona, i pari, gjatë ardhjes në postën jugosllave, që duhet të jetë shkelësi i ardhshëm, ndërsa i dyti gjatë largimit nga posta, që mund të jetë një nga ushtarakët e saj.

— Ky është një konkluzion logjik, — tha punëtori politik. Prandaj unë mendoj të fillojmë nga masat praktike.

Mbi bazën e këtyre përfundimeve kufiri në sektorin e postës, u përforcua, kujdes i veçantë ju kushtua drejtimit të Luginës së Qyqes, duke e mbyllur atë me njësit kufitar të palëvizshëm, të komanduar nga nënoficeri i shërbimit aktiv.


Shkelësi i kufirit, pasi ra errësira e natës, u fut rreth 100 metra në territorin tonë, u fsheh në një kaçube dhe qëndroi në përgjim. Aty rreth orës 21 e 30 minuta, agjenti i UDB-së jugoslla-

ve filloi lëvizjen duke ecur me kujdes të madh, duke kaluar nga njëra kaçube tek tjetra dhe herë pas here hidhte përpara ndonjë gur të vogël dhe priste derisa sigurohej se nuk kishte njeri përpara.

Njësitë kufitar në ora 19.30 minuta u nis në drejtim të rrugës automobilistike, eci ca në thellësi, e pastaj, me një manevrim të fshehtë doli në vendin e duhur, në rrugën kryqe dhe u vendos aty. Kufitarët morën formacion duke u vendosur në një kënd të gjerë, me pozicione të maskuara e dominuese dhe qëndronin në pritje, me fytyrë nga kufiri.

Nata nuk ishte shumë e errët. Rreth orës 22 e 30 minuta, para njësitit, në largësi jo më shumë se 300 metra, u dëgjua një zhurmë e mbytur, që vinte duke u shtuar. Përgjegjësi i njësitit u rikujtoi edhe një herë shpejt e me kujdes detyrat anëtarëve të njësitit e i porositi ata të rrinin gati. Urdhëri ishte që shkelësi të lejohej të hynte në darën e njësitit, t'i mbyllej atij drejtimi i kthimit prapa për në kufi dhe, të ndalohej e të kapej i gjallë, si të afrohej mirë.

Nuk kaloi shumë e u duk njeriu që lëvizte nga një kaçube në tjetrën. Pas pak, ai u ul në bisht, hodhi përpara dy-tre gurë të vegjël, njëri prej të cilëve i ra përgjegjësit të njësitit në kurriz dhe pastaj vazhdoi rrugën. Përgjegjësi e lejoi shkelësin të afrohej në largësinë e goditjes me bajonetë dhe me zë të fortë e urdhëroi: «Ndal!, «duart lart!». Në çast diversanti hodhi dorën te arma dhe u zbraps 4-5 metra për t'ju shmangur çdo goditjeje. Por në atë çast, papritur dëgjoi nga shpina një



thirrje tjetër dhe ndjeu në shpinë një goditje të automatiku. Ishte anëtari i njësitit që e bëri këtë sipas porosisë së përgjegjësit. Agjenti i UDB-së jugosllave, duke parë se s'kishte shpresë shpëtimi, lëshoi armën dhe ngriti duart.

Kufitari që mori urdhër ta kontrollonte e ta lidhte shkelësin, hodhi automatikun në qafë dhe filloi t'i kthente duart prapa. Dukej se çdo gjë shkonte në rregull; por papritmas shkelësi i kufirit duke shfrytëzuar gabimin e kufitarit, që nuk e urdhëroi të hapte këmbët, e goditi me një shqelm të fortë kufitarin dhe me një kërcim të shpejtë, u fsheh prapa një ferre dhe mundi t'i shpëtojë njësitit. Përgjegjësi i njësitit në dritën e raketës që hodhi e diktoi atë dhe hapi zjarr. Por plumbi e kapi shkelësin në dorë dhe ai mundi të lëvizte.

Me sinjalin e njësitit, u mbyll menjëherë kufiri, postat fqinje, siguruan krahët dhe populli mbylli mirë rajonin ku ndodhej shkelësi. Në të njëjtën kohë arriti me shpejtësi punëtori politik i postës me grupin e alarmit e qenin, i cili u vu në ndjekje të shkelësit, i cili kaloi lumin me not. Si qoli në bregun e kundërt, ai e lidhi mirë plagën dhe u nis në drejtim të kufirit. Udhëtoi nja 700-800 metra, dhe aty u ndesh me dy anëtarë të grupeve ndihmëse të katundit. U kthye përsëri prapa, drejt thellësisë, për të kaluar me shpejtësi pyllin e për t'u fshehur në shtëpinë e një kulaku, sipas rekomandimeve që kishte marrë.

I tronditur, i lodhur e i rraskapitur nga vrapimi i gjatë, diversanti vazhdoi lëvizjen nëpër monopatin pyjor, anës së cilës kishin zënë vend dy ushtarë të rezervës të repartit kufitar. Kur ata dë-

gjuan këmbët dhe frymëmarrjen e rëndë të tij, u bënë gati...

— Ta lëmë të afrohet dhe t'i hidhemi sipër që t'a zëmë të gjallë, — i tha më i vjetri në shërbim shokut.

— Me pak fjalë, t'a zëmë pa çak e pa bam, i themi ne nga nahija jonë. Po si do të veprimë?

— Të dy në një kohë! Kështu sulmi ynë do të jetë më me efekt.

Ndërkohë, duke shpejtuar hapat, sepse nga mbrapa kishte ndjerë zëra dhe këmbë njerëzsh që e ndiqnin, shkelësi u duk para tyre. Veprimi që i rrufeshëm. Kur grupi i kërkimit arriti në vend-vendosjen e dy kufitarëve, pa agjentin që ishte ulur në një korie lisash i ruajtur nga kufitarët.

— E, — ju drejtua shkelësit punëtori politik, — u përpoqe, u lodhe, por prapë nuk e shpëtove dot lëkurën.

— Ashtu është zoti oficer, por po të mos ishin këta dy djemtë, — ja bëri ai me kokë nga kufitarët, — kisha mundësi të shpëtoja ose të paktën, të mos bija gjallë në duart tuaja.

— E ku do të veje?

— Do të fshihesha në shtëpinë e kulakut dhe në rast se edhe këtu do të më gjenit, atëhere ampula...

Ai uli kokën i dëshpëruar.

* * *

Hetuesia nxori se i kapuri ishte kryeagjenti i UDB-së jugosllave, i hedhur në territorin shqiptar për ndërlihdje, veprimtari minuese dhe armiqë-

sore. Mbi bazën e deponimeve të tij, u arrestuan edhe bashkëpunorët.

Gjyqi kundër tyre, që u bë me dyer të hapura, u dha një tjetër goditje demaskuese tradhëtarëve demagogë — revizionistëve jugosllavë. Ajo ishte gjithashtu një shuplakë për Hrushovin dhe pasuesit e tij, — e përfundoi tregimin shefi.

NË FAQEN E MALIT

«Kufitari që s'njeh gjurmën, është
si muzikanti pa vesh muzike»

Roja e kooperativës u shkëput njëqind metra nga vendi i shërbimit, ju afrua baba Demirit, i cili ishte i shtruar i e këndshëm në muhabet, vuri armën në gjunjë dhe filloi të dridhte cigaren nga kutia e plakut.

— Dridhe, or trim, dridhe se është duhan i mirë.

I riu e drodhi cigaren ca me përtesë. Diç po mendonte.

— Të paska vajtur mendja për nuse që po mejtohesh kështu e ngacmoi plaku.

— Edhe ajo do të bëhet... por e kisha mendjen gjetkë, o baba... Njeriu nuk gjen karar. Sa isha në ushtri më shkonte mendja shpesh këtej nga kooperativa. Tani që u ktheva, më kujtohen jeta dhe shoqëria ushtarake.

— Ashtu është! Ku e kreve shërbimin ushtarak?

— Në Peshkopi, në një nga postat e kufirit në malin e Korabit.

— Ke të drejtë të mallohesh. Arma ku ke shërbyer, të bën për vete. Nuk shkëputesh dot. Unë e njoh ca shërbimin e kufirit, sepse jo vetëm që jam në zonën kufitare, por kam qenë edhe vetë kufitar.

Është më se e vërtetë baba Demir, por shërbimi i kufirit nuk është aq i lehtë, përkundrazi shumë i vështirë dhe delikat. Për të qenë kufitar i mirë duhet të jesh në një kohë: njeri politik, zbulues, ushtarak, mjeshtër i shërbimit kufitar dhe i fortë fizikisht, sepse kufiri jo vetëm që do kokën e freskët, zemrën e zjartë, duart e pastra, por edhe këmbët e lehta e të forta; kërkon që të jesh i kalitur për t'u bërë ballë kushteve të kohës dhe terrenit... Veçse aq sa delikate dhe e vështirë, aq e nderuar, tërheqëse dhe e dashur është arma ku kam shërbyer. Unë të them të vërtetën, në kufi mësova shumë, u poqa. Atje ruan kufirin e Shqipërisë socialiste, kufirin e popullit tonë.

Plaku psherëtimi thellë. E shikoi të riun në bebe të syrit dhe murmuriti:

— Po or bir ashtu është!

Të dy qëndruan një hop, pastaj plaku diçka donte të pyeste.

Kur babë Demiri u bë gati të thoshte atë që mendonte, u dëgjuan tre të shtëna pushke dhe një plasje granate. Qe sinjali i postës së kufirit. Porsa e dëgjonin pushkatarët këtë sinjal, zinin vendet e caktuara.

— Zërë me gojë qenin dhe bëj gati shkopin,
— tha Selimi dhe vrapoi me të shpejtë për të zënë vendin e tij.

—Shko dajë. Do t'i siguroj unë zyrrat e lokalitetit.

— Ki kujdes më shumë depon e bereqetit dhe telefonin.

20 minuta më parë, patrulla e kufirit, gjatë kthimit nga shërbimi për në postë, në afërsi të saj, qe takuar befasisht me dy shkelës kufiri. Gjatë shkëmbimit të zjarrit ishte vrarë një kufitar, ndër-sa shkelësit qenë larguar me shpejtësi. Me sinjalin e patrullës, «rashë në përpjekje», posta e kufirit, filloi kërkimin duke ngritur në këmbë edhe grupet ndihmëse të kufirit.

Po afrohej mëngjezi, qeni shkonte në mënyrë të sigurtë dhe me shpejtësi pas gjurmës dhe in-
struktori përpiquej të mos mbetej prapa e të mos i priste vrullin. Grupi i kërkimit, jo më larg se 4 km. nga vendi i ngjarjes dhe 500 metra nga bregu i lumit, arriti një nga shkelësit, i bëri thirrje të ndalonte, por ai nuk u bind edhe kur ju zbrazën nëpër këmbë dy breshëri automatiku. Me disa kapërcime të shpejta shkelësi u hodh në lumë dhe me not vazhdoi kalimin e tij. Me gjysmë frymë do-
li në bregun e kundërt dhe vrapoi me shpejtësi. Kur po ngjite të përpjetën e fortë, ai u ndal nga pushkatarët, të cilët kishin kohë që ndiqnin vep-
rimet e agjentit të UDB-së jugosllave. Shkelësi u kthye nga krahu tjetër, ku mendoj se mund të çante, por nuk mundi të bënte as 50 metra. Seli-
mi me një plumb e palosi të vdekur në bregun e lumit.

Pushkatarë trim e orientoi grupin e kërkimit në drejtimin ku mund të lëvizte diversanti i dy-
të. Së bashku me shokun e tij, para se të merrte kontakt me shkelësit, ai e kish dëgjuar bisedën e diversantëve dhe për afërsisht e kishte mësuar edhe vendin ku u ndalën ata. Grupi i kërkimit, i

orientuar nga këto të dhëna, së bashku me dy pushkatarë, u kthye në vendin ku dyshohej se qenë ndarë diversantët. Në të vërtetë, për afërsisht, në atë vend, u zbulua gjurma e shkelësit tjetër.

Qeni mori vazhden e re të gjurmëve.

Mirëpo ndjekja nuk qe e lehtë, sepse gjurmët ishin lënë në pjesën më të madhe në tokë të fortë. Në kilometrin e gjashtë qeni mbeti.

Forcat e kërkimit e kërkuan gjurmën në vende të buta. Më në fund ata e zbuluan dhe, vazhduan ndjekjen pa qen, por kur kërkimi doli në vend të fortë, ata e humbën gjurmën përsëri. Mbas dyzet minutash ushtarëve që ndiqnin shkelësin u sollën një tjetër qen kërkues.

Instruktor Tafili e pruri «Arapin» në kalë duke e mbajtur në shalë, me qëllim që ai të ruante forcat dhe me të mbërritur në vend, e vuri qenin menjëherë në ndjekje. Në fillim instruktori i qenit u përpoq të gjente gjurmën e humbur duke kontrolluar vendin rreth e për qark. Kur e humbiste gjurmën ai e kthente qenin në atë vend ku qe zbuluar gjurma e parë, ose aty ku gjurmët dukeshin më qartë.

Në anën e pyllit «Arapin» qëndroi, tundi kokën dhe fërkoj hundën në tokë. Instruktori e kuptoi gjuhën e mikut të tij. Gjurmët ishin spërkatur nga shkelësit me një lëndë neutralizuese.

Komandanti i Grupit të kërkimit mendoi se shkelësi, duke shfrytëzuar pyllin, ishte futur në fshat matanë pyllit me qëllim që më vonë të lëvizte në drejtim të thellësisë. Duke u nisur nga ky supozim, grupi i kërkimit u fut në pyll dhe pas pak doli përballë fshatit. Në disa kaçube, instruktori i qenit e vuri atë në kërkim. «Arapin» e gjeti gjur-

mën, por ai e humbi përsëri kur ju afrua një mu-llari me bar. Më tej, afër rrugës, mbi disa plisa u diktuan shenja të ngjashme me gjurmë këmbësh.

Për të shpejtuar ndjekjen, komandanti urdhëroi që instruktori të vinte qenin në gjurmë, ndër- sa kufitarët të mbyllnin drejtimin e daljes së shke- lësit nga fshati. Qeni vrapoi në drejtim të një par- cele perimesh. Atje gjeti gjurmën e plotë.

Duke lëvizur pas «Arapit», Tafili, pa të dilte nga një kasolle një njeri i armatosur, i cili vra- ponte me shpejtësi dhe i shqetësuar në drejtim të kaçubeve. Instruktori e lëshoi «Arapin» dhe qe- ni u vërvit si vetëtimë mbi shkelësin, e kapi në krahun e djathtë e pengoi jo vetëm që të lëvizte, por edhe të përdorte armën...

* * *

Pas një muaj e gjysmë, ngjarja po rikujto- hej. Në nënrepartin e vogël kufitar atë ditë kish- te gjallëri. Kufitarë dhe popull ishin pregatitur të festonin të gëzuar suksesin që kishin arritur mbi armiqtë e atdheut. Në rrugët që të shpinin për në postë, lëviznin të mëdhenj e të vegjël nga fsha- ti. Në mes tyre, dukeshin pushkatarët që patën marrë pjesë në përpjekje.

Sheshi para postës ishte plot me popull e kufitarë. Pjesëmarrësit bisedonin në mes tyre, të rinjtë këndonin dhe ja merrnin valles. Edhe babë Demiri u vinte pas të rinjve e duke hedhur ça- pat, e ndjente veten të gëzuar e krenar.

Nuk vonoi shumë e u vendos qetësia. Pranë komisarit, në presidium ishte sekretari i Komite- tit të Partisë të rrethit dhe babai i kufitarit dësh-


mor. Komisari e çeli me një fjalim të shkurtër mitingun dhe ja dha fjalën sekretarit të partisë.

Sekretari i partisë nisi të fliste me fjalë të ngrohta për trimërinë, guximin dhe vendosmërinë e pjesëmarrësve në veprimet kundër banditëve. Kufitarë e kooperativistë i dëgjonin ato fjalë dhe rriteshin edhe një herë aq sa ishin, pse ato u jepnin krah e guxim.

— Ne jemi kufitarë të Republikës Popullore të Shqipërisë, — thoshin vështrimet e tyre të ndezura nga krenaria, pastaj në gjokset e të dalluarve në përpjekje ndritën dekoratat, çdo njërin nga të cilat e shoqëroi një betim e një premtim: «Do të jem gjithmonë kufitar».

— Do të vete të zëvendësoj tim bir, — tha babai i kufitarit dëshmor. Ta marrë vesh armiku, se kufirin nuk e mbron dhe e ruan vetëm rinia, por edhe ne pleqtë.

Në sheshin pranë lapidarit filloi përsëri kënga dhe vallja. Lapidari qëndronte i lartë, ashtu si qëndrojnë trimat ndër beteja. Dhe ashtu i patundur dukej sikur thosh: Armiqtë nuk do të kalojnë kurrë mbi këtë truall!



PËRLESHJE TEK SHKËMBI I VETMUAR

«Ushtarët e oficerët tanë... Duhet të zhvillojnë sa më shumë memorjen vizuale, d.m.th. syri i tyre të jetë si një aparat fotografik, atë që e sheh një herë ta fiksojë mirë e të mos e harrojë terrenin ose diçka tjetër që e sheh tani, t'i gjejë sot dhe mot, jo vetëm ditën po dhe natën, jo vetëm në ditë me diell, por edhe kur ka mjegull, jo vetëm natën me hënë, por edhe kur ka tufan».

ENVER HOXHA

Ishte fillimi i dimrit. Në një kënd të dhomës së kulturës të një reparti kufitar qenë ulur dy kufitarë, shfletonin albumin «20 vjet Ushtri Popullore» dhe shkëmbenin edhe ndonjë fjalë me njëri-tjetrin.

— Sonte do të jemi bashkë në shërbim, — e hapi bisedën kufitar Delua, i cili nuk kishte më shumë se dy muaj që kishte ardhur nga qendra e instruksionit.

— Po, — ju përgjegj kufitar Hasani.

Fjalën e kufitar Hasanit e pasoi urdhëri i nënoficerit të rojes së postës që njësitit të përgatitë për të marrë detyrën luftarake.

* * *

Sa doli nga oborri i postës, patrulla e përbërë nga kufitar Hasani (përgjegjës njësitit) dhe nga kufitar Delua, filloi të lëvizte duke zbatuar rregullat e maskimit dhe duke vëzhguar, e gatshme për të vepruar menjëherë, në se do të takohej me shkelës të kufirit gjatë rrugës.

Rreth orës 22, kufitarët mbërritën në një luginë të vogël, ku sipas porosisë së komandantit të postës, u ndalën përkohësisht dhe filluan të përgjonin. Vend-vendosja ishte e përshtatshme për vëzhgim — një rrugë qerreje me kthesë të fortë në formë hunde, në majën e së cilës ata u pozicionuan, ndërsa në sfondin përpara ngrihej një kodër e bukur, mbi kurrizin e së cilës ndahej kufiri midis dy shteteve.

Nata ishte e kthjellët dhe kufitarët mund të përgjonin dhe të vëzhgonin. Në faqen e kodrës përballë njësitit, ngrihej një shkëmb në formë gjysmëcilindrike. Hasani, duke vëzhguar në faqen e kodrës, i ngulte herë pas here sytë tek guri dhe nuk fliste. Më në fund i dha sinjalin shokut të tij dhe, kur Delua u afrua, i tha:

— E shikon shkëmbin, në faqen e kodrës përtej?

— Po.

— E ke parë me vëmendje herë tjetër?

— Jo. Në këtë sektor vetëm dy herë kam kaluar. Përse pyet?

— Unë e njoh mirë terrenin në sektorin e postës dhe këtë mendoj se duhet ta kesh parasysh dhe ti, sepse ai është një nga elementet kryesore që duhet vlerësuar në shërbim për ruajtjen e kufirit. Shkëmbi, që kemi përpara, këtë radhë nuk paraqitet në formën e tij të zakonshme. Ai ka formën cilindrike, ndërsa tani, siç e shikon, nga e majta e tij duket një e dalë në formë koke.

— Mund të ketë rënë ndonjë gur tjetër mbi të, ose prapa tij ka qëndruar ndonjë shtazë e egër.

— Guri tjetër s'ka se nga të bjerë, ti e shikon që në kodër nuk ka gurë të tillë, ajo është kryesisht e pastër dhe e qëruar; ndërsa shtaza e egër përgjon rrallë në këtë mënyrë.

— Çfarë fshihet prapa gurit sipas teje, shkelës kufiri?

— Këtë do ta sqarojmë tani. Prandaj ti vrojto në atë drejtim, ndërsa unë, duke shfrytëzuar këtë rrëkenë këtu, do t'i dal shkëmbit nga prapa dhe do të pres vijën e kufirit. Në rast se atje është shkelësi i kufirit dhe ai do të lëvizë në drejtim të thellësisë së territorit tonë, ti vepro sipas udhëzimeve që na dha komandanti kur na nisi. I mban mend?

Përgjegjësi i patrullës lëvizi me kujdes, pa zhurmë dhe i doli shkëmbit nga prapa. Dyshimet e tij u vërtetuan. Një shkelës kufiri vëzhgonte drejtimin e kalimit, me qëllim që të lëvizte për në thellësi pa u zbuluar nga rojet tona. Kufitari trim ju turr shkelësit nga shpina, e sulmoi atë në befasi si rrufeja dhe menjëherë, thirri shokun t'i vinte në ndihmë. Ishin çaste dramatike. Të dy u kapën fytazi, herë Hasani e vinte poshtë shke-

lësin, herë ndodhte e kundërta. Duke u përleshur, të dy u rrokullisën në faqen e kodrës dhe po i afroreshin Delos, që edhe ai tanimë qe nisur në drejtim të tyre. Pas pak që të dy u ndodhën në këmbët e kufitarit të ri. Ky i fundit i drejtoi tytën e pushkës «agjentit» dhe e detyroi të ngrinte duart lart. Hasani së bashku me Delon e lidhën mirë «shkelësin» dhe i shtrënguan dorën shoku-shokut.

KATËR GJALLË NJË I VRARË

Në një nga ditët kur në Tiranë zhvillohej gjyqi special kundër organizatës tradhëtare dhe komplotiste në shërbim të zbulimit imperialisto-revizionist të kryesuar nga Teme Sejku dhe Tahir Demi, rreth orës 5.30 minuta, në Degën e punëve të brendshme të Peshkopisë arriti e dhëna se në një nga fshatrat e lokalitetit Zalldardhë, një person i panjohur, i cili hiqej si «mësues», qe takuar me djaloshin 11-vjeçar Xhelal Martinin dhe e kishte pyetur për kufirin. Pionieri i kishte treguar «mësuesit» një rrugë që në të vërtetë nuk të çonte në kufi, por në drejtim të shtëpisë së përgjegjësit të pushkatarëve dhe vetë, me kujdes e shpejtësi të madhe, duke kaluar nëpër një rrugë tjetër më të shkurtër, kishte njoftuar pushkatarin që ta priste personin e panjohur.

Pas gjysmë ore, «mësuesi» ishte kapur dhe nga të dhënat e para rezultoi se ai së bashku me katër shokë të tjerë, njëri prej të cilëve i armatosur më pushkë, kishte për qëllim të arratisesh në Jugosllavi.


Mbi bazën e këtyre të dhënave dhe nga sinjalizimet e qendrës, u forcua menjëherë kufiri në një sektor 10-15 km. dhe gjithashtu u aktivi-

zuan grupet e tjera ndihmëse dhe, më vonë, u ngrit në këmbë gati e gjithë krahina: burra e gra, pleq e plaka, të rinj e të reja.

Të katër shkelësit e tjerë të kufirit kur kuptuan se po ndiqeshin, vendosën ta shpejtonin lëvizjen, të mënjanonin kontaktin me forcat e kufirit dhe me popullin. Për këtë qëllim ata u ndanë në dy grupe. Grupi i parë mori drejtimin e fushës së Korabit, ndërsa i dyti u kthye prapa në drejtim të Bushtricës, me qëllim që të mashtronte forcat tona me anën e një manevre të rreme në thellësi të territorit tonë dhe pastaj të kalonte Drinin e të hidhej matanë kufirit në sektorin ku dyshohej më pak, me një fjalë të krahmerre sektorin e kufirit, të cilin forcat tona e kishin përforcuar.

Shkelësit e kufirit, të tronditur e të çoroditur, vazhdonin lëvizjen në këto dy drejtime. Por tanimë edhe pushkatarët, forcat e policisë dhe të kufirit, si dhe një masë e madhe nga populli ishin hedhur në veprim, duke bllokuar vendet kyçe dhe duke i kërkuar aktivisht shkelësit.

Rreth orës 14.30 minuta të datës 14 maj të vitit 1961 pushkatarët e një fshati, në vazhdim të kërkimit, ranë në gjurmët e shkelësve të kufirit dhe i arritën ata. Shkelësi i armatosur hapi zjarr, dhe së bashku me shokët e tij vrapoi në drejtim të kufirit. Pushkatarët ju përgjegjën flakë për flakë zjarrit të shkelësit, por pa rezultat. Pas pak ata u takuan me forcat e kufirit dhe së bashku vazhduan ndjekjen e tradhëtarëve. Shkelësit, kur panë arritjen e forcave të kufirit, e shtuan më tepër shpejtësinë për të kaluar kufirin. Por pas pak ata u çorientuan, shkëputën ndër-



lidhjen me njëri-tjetrin dhe njëri prej tyre u kthye në thellësi me qëllim që të fshihej në disa stane të pabanuara. Mirëpo, grupi i kërkimit të postës së kufirit nuk ju nda. Atëhere shkelësi fshehu pushkën në stan dhe vrapoi në drejtim të përroit, por zjarri paralajmërues i kufitarëve e detyroi të ngrinte duart. Shkelësi tjetër i këtij grupi mundi të shkëpuste kontaktin me forcat e kufirit dhe u largua në drejtim të fshatit Radomirë, por edhe ai, i detyruar nga vrojtuesit e postës që vraponin për t'i prerë rrugën, u kthye në drejtim të kundërt. Atje ai u ndesh me një grup pushkatarësh, por mundi të largohej. Forcat e kufirit të postës kufitare, që arritën bashkë me pushkatarët, vazhduan ndjekjen e shkelësit. Nga përpara, atij ja prenë rrugën rojet e postës kufitare të Radomirës, të cilët meqenëse ai s'pranoi të dorëzohej, e goditën me dy predha automatiku duke e lënë të vvarë.

Dita e 14 majit mbaroi me kapjen e dy shkelësve dhe me likuidimin e të tretit.

Nata ra, por ndjekja e shkelësve, me gjithë kushtet e vështira, vazhdoi. Duke u gdhirë 15 maji, u kontrollua vija e kufirit dhe kalesë nuk u konstatua.

Manevra e grupit të dytë të shkelësve i detyroi forcat tona të rigrupoheshin, të forconin kufirin në sektorë më të gjerë, sidomos në krahun e majtë dhe të zgjeronin rajonin e blokimit, sidomos në drejtim të thellësisë, duke përdorur për këtë qëllim edhe disa forca nga reparatet e ndjekjes. Veç këtyre masave, në disa vende kyçe u vendosën pika kontrolli të policisë, ndërsa në të dy krahët e ndarjes administrative

Dibër-Kukës, u organizua kërkimi i shkelësve me pjesëmarrjen e grupeve ndihmëse. Të gjitha këto masa e dhanë frytin e tyre. Rreth orës 12 të datës 15 maj, të dy shkelësit e tjerë të kufirit, gjatë orvajtjes për të kaluar Drinin, u përpoqën në befasi me patrullën e policisë. Njëri u kap aty për aty, ndërsa tjetri mundi të largohej, por dhe ai u ndesh me pushkatarët që ruanin të dy krahët e urës së Dodës dhe pësoi të njëjtin fat.

KËMBËT E NGRIRA

«Në luftë me vështirësitë duhet të kalitet shpirti dhe trupi i kufitarit të Shqipërisë së re»

ENVER HOXHA

Bënte dimër i fortë. Bora kishte kaluar një metër dhe era e suferina të merrnin frymën. Posta e kufirit dhe katundet malore ishin izoluar. Megjithëse masat e sigurimit për dimrin, sidomos për veshmbathje, ishin marrë, ato nuk u përgjegjeshin plotësisht kushteve të atij dimri të jashtëzakonshëm.

Për shkak të kushteve të vështira atmosferike shërbimi në kufi kryhej nga njësite e patrulla që qëndronin në sektorë një kohë të shkurtër dhe që e kryenin shërbimin duke qenë më tepër në lëvizje.

Oficerët e postës i udhëhiqnin vetë njësitet në shërbim, asistonin në ndrrimet dhe rrinin së bashku me kufitarët në borë e në tufan. Edhe komandanti i postës ishte në krye të një njësi dhe jetonte afër ushtarëve, duke i inkurajuar ata me shembullin e tij.

Një ditë, aty nga ora 11, një grup kufitarësh me komandantin në krye, marshonte drejt vijës së kufirit duke çarë borën. Pas 30 minutash rrugë njësitit u ndal pranë kodrës ku ndodhej pika e vrojtimit. Komandanti i postës urdhëroi të bëhej një pushim i shkurtër.

— Po ti, pse çaloje gjatë rrugës, — e pyeti komandanti një kufitar kur ata u ulën.

Nuk kam gjë, shoku komandant, vetëm gish-ti i vogël më nget nga pak, — iu përgjegj kufitari. Shokët e tjerë shikuan njëri-tjetrin. Komandanti dyshoi dhe e urdhëroi kufitarin të nxirrite çizmet. Kufitari i hoqi çizmet dhe pecet. Këmbët i kullonin gjak, gjishti i vogël i njëres këmbë i qe qelbëzuar. Komandanti i postës nxori pistoletën shenjë-dhënëse dhe me një raketë kërkoi grupin e alarmit, që nuk vonoi shumë të vinte. Së bashku me këtë të fundit, u kthye në postë edhe kufitari i sëmurë.

Pasi eci dhe ndonjë copë herë njësitit kufitar arriti në pikën e vrojtimit. Oficeri shumë pak kuptoi nga ajo që i raportuan, sepse ndërsa përgjegjësi fliste, të tjerët kollitëshin pa pushim. Si mbaroi raporti, komandanti i hoqi mënjanë ushtarët e njësitit dorëzues dhe para se ata të niseshin për në postë, i pyeti si ishin me këmbët.

— Ah, shoku komandant, ai nuk është as i pari, as i fundit që ka këmbët në gjendje të tillë, — u përgjegj përgjegjësi i njësitit.

— Po përse nuk raportoni, shoku kufitar, që të manevrojmë kur bëjmë planin e shërbimit? Ne, para se t'ju japim detyrën luftarake, ju pyesim, «Jeni në gjendje për shërbim?» Gjer tani asnjëri s'është ankuar. Ç'është kjo me ju!

Ne oficerët jemi prindërit dhe vëllezërit tuaj, këtu në kufi jemi si një familje e duhet t'i qajmë hallet së bashku.

— Ç'farë t'u themi, shoku komandant, — u hodh njëri nga ushtarët e tjerë, të cilin nuk e linte rehat kolla. — Dimri i sivjetëm është i veçantë, prandaj edhe ne do ta ruajmë kufirin simbas këtyre veçorive, në të ftohtë, në borë e tufan, ashtu si e kanë ruajtur shokët tanë paraardhës, ashtu siç kanë luftuar në borë dhe në tufan partizanët tanë trima. Pastaj edhe sikur t'u themi gjë, ç'do të bëni? Ne gati që të gjithë jemi të saktosur nga të ftohtit, njëri nga këmbët, tjetri nga kolla. Edhe ju vetë nuk jeni më mirë nga ne.

— Kështu është, — e mori përsëri fjalën përgjegjësi i njësitit. Ne kufirin nuk mund ta lëmë bosh. Agjentët dhe diversantët më të rrezikshëm këtë kohë presin.

— Mirë e keni ju, or trima, por çdo vështirësi ka një rrugëdalje, komanda eprorë, po të jetë nevoja, mund të na vijë në ndihmë me rezervën duke na zëvendësuar të paktën ata kufitarë që janë më rëndë. Prandaj duhet t'i hapni zemrën komandës dhe t'i tregoni gjendjen tuaj shëndetësore. Njeriu ynë është kapitali më i çmuar, ai e ruan kufirin.

Pas kësaj bisede, njësitë dorëzues u largua, ndërsa marrësi, me në krye komandantin e postës, u fut në pikën e vrojtimit.

— Ditën është më lehtë të kryesh shërbimin tani në dimër, sepse rri brenda në kullë duke pa-tur dhe zjarrin afër, ndërsa natën, jashtë është errësirë e fryn. — i tha komandanti njërit prej ushtarëve.

— Edhe ne natën na sëmuren këmbët, — u përgjegj kufitari tjetër.

— Shiko, shiko, na doli një tjetër i sëmurë! Pa hiqi edhe ti çizmet dhe ulu tani këtu, pranë zjarrit, mos dil fare jashtë. Shërbimin do ta kryej unë me shokun tënd.

— Jo, shoku komandant, mos e bëni një gjë të tillë, mos më fyeni. Një burrë 40-vjeç si ju të më zëvendësojë mua? Ndihma më e mirë që na jepni është vetë prania juaj, shembulli personal, kujdesi që tregoni për ne. T'jua them hapur, sot mua më duket se kam në krah babain tim.

* * *

Njësitë kufitar, që kryesohej nga komandanti i postës, pasi mbaroi afatin e shërbimit, u kthye për në postë. Punëtori politik e njoftoi komandantin, se gjatë mungesës së tij kishte ardhur nga fshati kryetari i kooperativës bujqësore dhe i kishte propozuar që ushtarët e sëmurë nga këmbët të mos i nxirrnin në shërbim, sepse organizata e partisë dhe kryesia e kooperativës kishin vendosur që ata t'i zëvendësonin me djem të armatosur nga fshati. Shkak i këtij vendimi ishte kthimi i ushtarit të sëmurë nga këmba. Nga sinjali që kishte dhënë me raketë komandanti për thirrjen e grupit të alarmit, kooperativa ishte vënë në gatishmëri dhe kur kooperativistët kishin parë grupin e alarmit me ushtarin e sëmurë që kthehej, u interesuan dhe e morën vesh shkaku.

— Mirë kanë menduar, në fund të fundit ne mund të caktojmë me shërbim dy kufitarë dhe

një nga ata. Por para se të marrim një vendim të tillë, duhet të njoftojmë komandën eprorë, t'i raportojmë gjëndjen e kufitarëve dhe në këtë rast të vëmë në dukje dhe gatishmërinë që tregon kooperativa. E kuptoni se çfarë njerëz të mrekullueshëm na rrethojnë shoku komisar? Veçse ne, nuk i njohim aq sa duhet këto cilësi, sepse ende nuk ju futemi mirë në zemër dhe në shpirt njerëzve. Unë sot gjatë vajtjes në vrojtim, ashtu si edhe ti mbrëmë, zbulova ushtarë të tjerë të sëmurë nga këmbët dhe asnjë nuk më tha një fjalë ankimi...

— Është më se e vërtetë, edhe ata e shikojnë që e kemi të vështirë t'i zëvendësojmë.

— Bisedën me oficerët e ndërpreu zilja e telefonit. Ishte komisar i batalionit, i cili në fund të bisedës urdhëroi që ushtarët e sëmurë të niseshin për në spitalin e qytetit, sepse ata do të zëvendësoheshin nga rezerva e repartit.

NDËRGJEGJJA E KUFITARIT

Preng Nikolla, burrë i moshuar, qe ulur në qoshe të vatrës, kishte vënë xhezven e kafesë në zjarr dhe mbushte me duhan llullën e tij. Në dhomë u dëgjua trokitja e derës dhe pas pak hyri postieri.

— A jeni gjallë bre, se kam gati gjysmë ore që trokas, — thirri ai, që të justifikonte sado pak futjen pa leje në shtëpi.

— Gjallë e mbi dhe, hej burrë, — ju përgjegj Prenga dhe u ngrit në këmbë.

— A jeni si jeni, a keni mujt, a jeni lodhë.

— Falemnderës, po ti si je, si i ke te shtëpia. Ulu bre burrë të pimë një duhan e një kafe.

— Jo, or Preng, ndonjiherë tjetër se shpejtohem. Merre këtë letër nga djali.

— Të lumtë dora, hej burrë i dheut! — uroi i zoti i shtëpisë, i cili kur postieri u largua, i bëri zë gruas së tij dhe të shqetësuar filluan të bisedonin.

— Si asht e mundun që na dërgoj letër kaq shpejt? Nuk ka dhjetë ditë që asht largue nga shtëpia. Mos i ka ndodhë gja.

— A të shkoj ta thërras vajzën e komshisë, Shkurtën e Mark Tomës? Ajo din me lexue.

— Hajde grue, hajde. Në këtë letër ka diçka, pse ta marrë vesh tanë dynjaja.

— Ke të drejtë burrë, duhet të ketë diçka, sepse ai u largue nga shtëpia i mërzitun.

— I mërzitun e i revoltuem, bile Ndues i kishin dhanë 7 ditë leje dhe nuk qëndroi asnji ditë. mirë na e bani, po të isha unë nuk do të qëndroja asnji orë, por djali u tregue i pjekun dhe gjakftohtë.

— Po ti që hiqe burrë i mirë, pse u pajtove me telegramin, — e thumboi Dranja të shoqin.

— Si tue qeshë, oj grue, e more hakun. Po, unë jam fajtor që rrejta, tue të ba ty të sëmundë, se më kishte marrë malli: Apo s'jam prind unë?

— Lene mos e nga, burrë, se edhe unë kam fajin tim. Por prit njëherë, të mos shpejtohemi, se nuk dihet, letra mund të mos ketë lidhje me telegramin.

— Ndoshta i ka ndodhë gja rrugës. Dreqi e din!

Këtë çast dikush trokiti në derë dhe pas pak hyni në dhomë djali i vogël i shtëpisë, Zefi 12-vjeçar, i cili sa ja pa s'amës letrën e vëllait, ja rrëmbeu nga duart, e çeli dhe filloi ta lexonte me zë.

«Të dashtun prind!

Mbërrita mirë, gëzohem që dhe ju kjo letër t'ju gjejë shëndosh e mirë. Më vjen keq që unë djali juej që më keni ba kokën dhe më keni rritë me halle e vështirësina, t'ju qortoj e t'ju jap mend, por jam i bindun se do të më kuptoni drejt dhe do të jepni hak.

T'ju them të drejtën, unë nuk e prisja një gja të tillë nga ju, dhe kur mora telegramin u

shqetësova, sepse ashtu siç paraqitej gjendja e nanës në telegram, u tremba se nuk do ta shihja ma; megjithatë nuk i thashë njeriut dhe nuk kërkova as leje, sepse siç u fola edhe natën që erdha në shtëpi, ne ishim në gatishmëni. Por në kohën kur lexoja telegramin dhe kur u shqetësova më pa njeni nga shokët e mi, sekretari i organizatës së rinisë, i cili m'u afrue dhe më pyeti në se më kishte ndodhun gja në familje, unë nuk i thashë gja, por të nesërmen më thirri komisari, më kërkoi telegramin dhe pas pak u mblodh gjithë efektiv i postës, ku u ngrit çështja ime dhe u rekomandua, qe pavarësisht nga gatishmënia, unë të shkoja me leje për të parë «nanën që e kisha të sëmundë randë». I gjithë kolektivi ishte dakord dhe, pasi u muer aprovimi i komandës eprore, u nisa me leje.

Kur mbërrita në shtëpi dhe pashë nanën që s'kishte asgja, m'u errën sytë dhe m'u duk sikur më ra tavani i shtëpisë. Por e mbajta veten, nuk e shpreha plotësisht moskënaqësinë time dhe vendosa që qëndrimin tuaj aspak të denjë, ta dënoj me largimin nga shtëpia, pa e plotësue as 10 për qind lejen që m'u dha.

Tashti me anën e kësaj letre desha të shprehja edhe një herë mos aprovimin e premë dhe të vendosun të këtij qëndrimi, se një veprim i tillë në kohën tonë nuk mendoj të ketë ndodhun asnjherë. Unë e kuptoj që ju nuk e dinit që posta e kufinit ditën që më dërguet telegramin ishte në gatishmëni. Megjithatë ju dinit një gja, që djali juaj ishte duke kryer detyrën e shenjtë, shërbimin ushtarak në kufinin tonë, të rrethuem nga an-

miqtë dhe ai pa arësye shumë të forta nuk duhej të largohej nga posti luftarak.

Prandaj të dashtun prind, largimin tim pa mbarue lejen, kritikën që ju bana kur erdha në shtëpi dhe këto që po ju shkruiej, i kuptoni drejt dhe mos u zemëroni me mue.

Me kaq letrës i jap fund.

Shkurtën e Zefin i qafoj nga larg. U bani të fala të gjithëve që do të pyesin për mue.

Ju përqafoj, djali juej
Ndue Nikolla

Prindërit u prekën nga kjo letër, dhe që të dyve një fytyrë u vinte, një fytyrë u ikte, kur Zefi i vogël e lexonte. Megjithatë, ata, në prani të fëmijës e mbajtën veten edhe kur ky i fundit i kritikoi duke mbrojtur të vëllanë.

Pasi Zefi doli jashtë, ata të dy e analizuan mirë këtë çështje, i dhanë djalit plotësisht të drejtë dhe mbetën dakord që të bënin autokritikë para kolektivit të kooperativës, i cili vendosi që letërën e kufitarit t'ja dërgonte komandës ku ai shërbente dhe t'i thoshte që ashtu si bashkëfshatarët e tij, edhe reparti kufitar të krenohet me ndërgjegjen e lartë të këtij kufitari.

Letra e Ndues, që u kishte bërë prindërve, së bashku me shënimin e kooperativës, u lexua edhe para kolektivit të postës së kufirit.

INICIALET E PËRGJAKURA

Komandanti i postës së kufirit porsa e kishte mbaruar planin e shërbimit, kur komanda e reparitit njoftoi, që një nga ushtarët e kufirit duhej të nisej për në qytet për të takuar babain e tij, i cili kishte ardhur nga fshati. Kufitari duhej të shkonte së bashku me një shoqërues. Kështu që plani i shërbimit dështoi.

Ishte ora 18. Komandanti i postës rrinte duke u menduar në zyrën e tij, kur hyri kufitar Bentua — komunist dhe përgjegjës njësit.

— Hë Bento, ç'kemi, — e pyeti komandanti.

— Mora vesh se largohen dy kufitarë nga posta për në qytet. Pra, mbetet pa mbuluar me njësit një nga drejtimet.

— E po s'ke ç'bën. Gjëra që ndodhin. Po ti mos u mërzit, se drejtimin kryesor nuk do ta lëmë bosh.

— Me se do ta sigurojmë?

— Në llogarinë e një drejtimi tjetër më pak të rëndësishëm.

— Po përse të heqim njësitin edhe nga ai drejtim? Nuk dihet.

— Çfarë të bëjmë sipas mendimit tënd? Nga

Ilogaria që bëra, vetëm një ushtar më tepron, dy të tjerët ku t'i gjej?

— I gjejmë shoku komandant. Ja se si: Gjatë 24 orëshit rojet e postës të bëjnë jo nga 8 por nga 12 orë. Kështu nga tre ushtarët që janë caktuar për roje poste në këtë 24 orësh, lirohet një. Tjetrin e keni ju, atë që ka tepruar, ndërsa i treti jam unë.

— Ti në drekë u ktheve nga shërbimi i ditës dhe tani kërkon të shkosh përsëri? Nuk mund të të lejoj. As ti vetë nuk je në gjendje. — Në luftë apo në situatë të veçantë në kufi, shoku komandant mbingarkesa është e zakonshme. Pse sot, në një rast, të mos e bëjmë?

Përgjegjësi i njësitit kishte zë të qetë e të vendosur.

— Mirë, bëje gati njësitin dhe pas gjysmë ore paraqitu të marrësh detyrën luftarake, — vendosi tanimë, pa ngurim komandanti.

Rreth orës 21, diku larg në kufi, në «Grykën e ujkut» lëviznin duke mbajtur largësinë e duhur me njëri-tjetrin dy kufitarë dhe përgjegjësi. Nuk kaloi shumë kohë kur njëri nga kufitarët, ai që printe përpara, u ndalua. Bentua ju afrua shokut të tij dhe sqaroi se jo më tepër se 400-500 metra nga njësit, në territorin tonë që dëgjuar një zhurmë. Kufitarët u vendosën në pozicione dhe filluan të përgjonin, me qëllim që të përcaktonin më mirë zhurmën dhe drejtimin e saj. Më rëpo kaluan 10-15 minuta dhe zhurma nuk po dëgjohej më. Kufitarët dyshuan se mos atë zhurmë e kishin shkaktuar shtazë të egra. Megjithatë Bentua i porositi kufitarët që të kishin kujdes. Pas pak, kur njësit i bëri ndalesën e dytë afër

«Grykës së ujkut», u godit në befasi me zjarr nga një grup monarko-fashistësh grekë që ishte futur në territorin shqiptar. Kufitarët tanë ju përgjegjën zjarrit të armikut flakë për flakë, megjithëse ndodheshin në pozicione të vështira dhe ishin shumë më pak në numër nga armiqtë. «Gryka e ujkut» gjëmonte nga zjarri i pushkëve, automatikëve dhe granatave. Përgjegjësi i njësitit u plagos rëndë, por ai nuk u tha shokëve, sepse nuk donte t'i dekurajonte dhe vazhdoi të luftonte. Por kur pa se gjaku i rridhte pa pushim dhe nuk kishte shpresë shpëtimi, nxori taserën e partisë, e futi nën një gur për të mos i rënë në dorë armikut dhe me gjakun e tij të kulluar shkroi në faqen e sipërme të saj gërmat «P.E.», që ishin inicialet Parti-Enver. Pastaj e mbështeti kokën rrëzë gurit të lëmuar dhe mbylli sytë. Ai ra ashtu siç kanë rënë mijëra dëshmorë në Luftën nacionalçlirimtare, për mbrojtjen e kufive tanë, për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit në vendin tonë.

GRA ME ZEMËR USHTARI

Kooperativa e bashkuar dallohej për ndihmën e madhe që jepte në ruajtjen e kufirit dhe për lidhjet e ngushta që ajo mbante me kufitarët. Si rezultat, një përqindje e mirë e shkelësve të kufirit në atë sektor ishin kapur nga vetë kooperativistët.

Ishte ditë vere dhe kooperativistët qenë mobilizuar për prashitjen e misrit. Brigadat në garë me njëra-tjetrën punonin me vrull për tu kryer bimeve shërbimin në kohën e duhur. Flamuri tranzitor kalonte si stafetë dorë më dorë, nga një brigadë në tjetrën.

Ndërsa në majën e një gorice në formë trekëndëshi valonte flamuri kombëtar simboli i luftërave dhe i fitoreve, rreth pemës punonte duke kënduar brigada e Frosinës, një vajzë e re, me një shall me ngjyrë limoni të lidhur në kokë.

Duke përdorur me mjeshtëri shatën, brigadierja i udhëhiqte shoqet e saj që nuk mbeteshin prapa saj, bile kishte dhe raste që ja kalonin.

Aty nga ora 12 kooperativistët u shtruan nën hijen e goricës për të ngrënë drekën. Frosina, me një nga shoqet e saj, mbaroi e para së ngrëni dhe zbriti të mbushte ujë në një burim aty afër.

Gjatë kthimit, vajzat u takuan me një person të panjohur që nga pamja e jashtme të linte përshypjen e një njeriu jo vendës. Ai kur i pa kooperativistët, i përshëndeti me përzemërsi dhe i pyeti për një grykë, nëpërmjet së cilës kalohej në Greqi.

— Ja, a e shikoni atë përtej, — ju përgjegj duke ja bërë me dorë shoqja e Frosinës.

— Po përse pyetni? Ku do të shkoni? — ndërhyri brigadierja.

— Kot pyeta. Unë do të shkoj në fshatin rrëzë malit, te një miku im dhe dua të di rrugën më të shkurtër.

— Po, për të dalë në fshat, ka dy rrugë; kjo që ke marrë dhe tjetra matanë, që kalon në afërsi të kufirit, në brezin 500 metra.

Kur Frosina mbaroi fjalën e saj, i panjohuri, aty për aty, ndërroi fytyrë, por e mblodhi veten, i falënderoi vajzat dhe vazhdoi rrugën. Edhe brigadierja nuk e zgjati më bisedën, me qëllim që të mos i jepte të kuptonte se kishte dyshuar, dhe kur i panjohuri u largua ca, i tha shoqes së saj:

— E, ç'thua ti, të jetë udhëtar i zakonshëm ky?

— Po çfarë të jetë?

— Njeri i dyshimtë më duket. Siç e shikon, kufiri këtej është afër, sa herë jemi ndeshur ne me shkelësit e kufirit. Ai për të shkuar në fshat nuk kishte përse të pyeste për grykën, sepse andej bie më larg. Prandaj unë mendoj që këtë çështje të mos e lëmë pa sqaruar. Ti hidhu me shpejtësi te brigada e burrave, merr dy-tre prej tyre, sidomos Thanasin dhe Vangjelin, që janë të armatosur dhe t'i qepemi prapa e ta ndalojmë. Ndër-

sa unë do të qëndroj majë këtij guri dhe do të ndjek me vëmendje lëvizjet e tij gjersa të vini ju.

— Mirë, — u përgjegj ajo dhe fluturoi si era.

Pas gjysmë ore, në ndjekje të personit të panjohur u vunë tre pushkatarë dhe dy kooperativistë. Ata e arritën atë në një largësi 200-300 metra nga gryka dhe i bënë thirrje të ndalej. I panjohuri nuk u bind, por vazhdoi qetësisht rrugën. Vetëm kur njeri nga pushkatarët e qëlloi mbi kokë me një të shtënë pushke, u detyrua të qëndronte.

— Prej nga je dhe ku shkon, — e pyeti përgjegjësi i pushkatarëve?

— Nga Himara, ndërsa ku shkoj e di ajo, — e drejtoi gishtin tregues në drejtim të Frosinës.

— Ne nuk dimë ku shkon, prandaj dyshojmë.

— Ç'kërkoni, unë jam njeri i zakonshëm si gjithë të tjerët. Vete te një miku im, me të cilin kam qenë ushtar e më ka ftuar.

— Ne nuk kërkojmë gjë, por këtu është zonë kufitare dhe e kemi për detyrë të verifikojmë zbatimin e rregullave të regjimit të kufirit, — ndërhyri përsëri Frosina.

— Që nga Himara ke ardhur për miqësi! — e mori fjalën përgjegjësi i pushkatarëve.

— Po, po, që nga Himara. Nuk ka asgjë për t'u çuditur më duket.

— Mirë, mirë, por a ke leje hyrje nga dega e punëve të brendshme, për në katundin ku do të shkosh?

— I panjohuri hodhi dorën në xhepin e xhakëtës, nxori kuletën dhe, pasi bëri sikur kërkoi, u përgjegj gjoja i shqetësuar se nuk e kishte, duhet t'i kishte rënë duke paguar paratë e hotelit.

— Pa leje nuk mund ta lejojmë të shkojë në zonën kufitare, prandaj të shoqërohet për në postën e kufirit si shkelës i rregullave të regjimit kufitar, — i tha Frosina përgjegjësit të pushkatarëve.

— Ç'ke ti moj bushtër që m'u qepe, unë shkoj vetë në postë dhe në rast se ajo nuk më lejon, nuk është puna jote.

— Kufiri nuk është vetëm i postës, por yni, i gjithë popullit.

Kur përgjegjësi i pushkatarëve e pa që po acarohesh situata, i futi fishekun në gojë «belxhikut».

Këto pregatitje e qëndrimi i prerë i kooperativistëve nuk i shpëtuan syrit të shkelësit, i cili s'gjeti rrugë tjetër më të mirë se sa bindjes për të shkuar në postën e kufirit.

Nga hetimet e bëra doli se i panjohuri ishte emigrant i kthyer nga Amerika, i dërguar me detyrë zbulimi dhe meqë nuk kishte tjetër mundësi ndërlihdheje, kishte vendosur të kalonte kufirin për të realizuar detyrat e ngarkuara nga padronët e tij.

GRACKA

Tanimë është e njohur ndihma e madhe që u japin kufitarëve njerëzit me profesione të tilla, si sharrëxhinj, druvarë, barinj dhe rojtarë.

Ishte ditë e bukur dhe e freskët. Bagëtitë e kooperativës kishin dalë në kullotat verore jo shumë larg nga kufiri. Delet ishin shpërndarë nëpër një pllajë të bukur dhe kullotnin duke u drejtuar frontalisht përpara. Bariu i tufës ishte ulur në një gur, kishte vënë fyellin në anën e djathtë të buzëve dhe po i binte melodisë popullore «Dhëntë në ujë».

Në ato çaste, para tij u shfaq një civil, i cili ju afrua, e përshëndeti dhe e pyeti atë në se ishte larg posta kufitare jugosllave. Bariu reagoi në çast dhe ju përgjegj në gjuhë të huaj, sepse ai ishte nga fshatrat e Prespës, se posta nuk qe shumë larg, duke i plotësuar thënjet me gojë duke bërë shenja me dorë.

Mirëpo, personi nuk e pa dot me sy postën e kufirit, sepse e pengonin lisat, kështu që ju lut bariut ta shoqëronte gjer afër saj. Bariu në fillim nguroi duke vënë si shkak se s'mund të linte bagëtinë vetëm, pastaj bëri sikur ju bind e i tha të

panjohurit që të ecte përpara drejt rrugës gjersa të fuste bagëtinë në vathë.

Pas pak, personi dhe bariu ishin duke zbritur në drejtim të postës. Ata e vazhduan rrugën gati 20 minuta dhe kur ju afruan postës jo më shumë se 100 metra, bariu i thirri nënoficerit, ashtu siç ishte nga prapa të panjohurit dhe i tha:

— Shoku nënoficer, ky miku kërkon të dijë ku është posta jugosllave, prandaj edhe ua solla ta shoqëroni dhe pastaj bariu qeshi.

— Ah, ç'ma hodhe, i tha i panjohuri bariut tërë inat dhe i zverdhur në fytyrë kur e pa kurthin që ishte organizuar.

— Pse, kujtoje se do të shpëtoje nga duart tona? — ju përgjegj bariu.

— Duart lart! — thirri nënoficeri i rojes, duke i drejtuar pistoletën dhe urdhëroi dy kufitarë që ta futnin brenda në postë.

— Ty, or trim, të lumtë, hajde ta tokim një herë dhe të pimë një cigare, — ju drejtua ai bashkëpunëtorit aktiv të postës.

— Jo, shoku nënoficer, të falemnderit, iani kam bagëtinë vetëm. Herë tjetër do të vij të bisedojmë si ngaherë.

Nga pyetjet që ju bënë shkelësit, doli se ai kishte dashur të kalonte në Jugosllavi dhe kur dëgjoi bariun që fliste maqedonisht, kujtoi se ishte futur në territorin jugosllav. Prandaj i qe lutur që ta shoqëronte për në postë. Shkelësi kishte dyshuar që bariu i rrinte prapa dhe larg, por mendoi se e bënte ngaqë nuk mund të largohesh shumë nga bagëtia.

PUNËTORËT NË POZICIONE

«Luftën që prish njerëzinë nuk do ta doja kurrë, por në më shkelshin kufinë, do të luftoja si burrë».

A. Z. ÇAJUPI

Kjo ngjarje ka ndodhur në një kohë kur në kufitë tona shtetet fqinje po bënin provokacione të armatosura të vazhdueshme. Forcat tona të kufirit kishin urdhër të ruanin gjakftohtësinë. Kur këto provokacione arritën kulmin, forcat tona të kufirit morën urdhër që të përgatiteshin për një kundërgoditje të rrufeshme. Për këtë qëllim, u vendos që edhe punimet për ndërtimin e postës së re, të kufirit në rajonin N të ndërpriteshin përkohësisht. Në lidhje me këtë, komandanti i postës kufitare i njoftoi punëtorët e ndërtimit që të largoheshin disa ditë dhe të ktheheshin kur t'i njoftonte komanda, duke e motivuar largimin me situatën e vështirë që ishte krijuar në sektorin e postës, situatë që kishte mundësi në të ardhshmen të vështirësohej më shumë. Muratorët e dëgjuan me vëmendje oficerin e kufirit dhe kur ai mbaroi, përgjegjësi i tyre i tha:

— Ne e kuptojmë pse doni të na largoni, por ne nuk jemi dakord që të ikim. Ku të shkojmë? Për ne nuk ka vend prapa, në një kohë kur këtu mund të vijnë forca nga thellësia për të mbrojtur kufirin.

— Mirë, mirë, por unë kam urdhër nga lart, e kuptoni? — ju përgjegj oficeri.

— Ne e kuptojmë këtë, por njoftoni komandën se ne nuk largohemi nga posta, — ndërhyri një djalë i ri. Më mirë na jepni armë e të zëmë pozicione bashkë me ju.

— Po, po, — ja priti punëtori tjetër, — ne e kemi detyrë të zëmë vend në këto pozicione.

Në këtë kohë në postë mbërriti komandanti i repartit, i cili si i dëgjoji punëtorët dhe me buzë në gaz u ra krahëve shkoi në zyrë. Aty ai foli në telefon me qendrën dhe pas pak i njoftoi muratorët se dëshira e tyre ishte plotësuar dhe i falënderoi për zemërsisht në emër të ministrit të punëve të brendshme për patriotizmin dhe gatishmërinë që treguan.


Mbas disa minutash në formacionin luftarak të postës u dukën forca të përziara ushtarake dhe civile. Ishte çast frymëzues e mobilizues, kur shikoje që në mes të ushtarëve qëndronin në pozicione me zemrën e zjarrtë dhe syrin pishë, punëtorët, duke shtrënguar armët fort në duart e tyre me kallo. Kjo ishte me të vërtetë një tablo kuptimplote që tregon se kufirin e mbron dhe e ruan një popull i tërë.

Mirëpo, mbas pak, ndodhi ajo që ngjiste vazhdimisht kur forcat tona bëheshin gati për kundërgoditje. Trupat provokuese të shtetit fqj filluan të

largoheshin nga pozicionet dhe pushuan zjarrin,
sharjet dhe fyerjet.

— S'qenkan fare budallenj monarkot, ditkan
ta ruajnë lëkurën, — tha një djalë i ri, të cilit i
hanin duart e i ziente në dej gjaku i kuq i shqip-
tarit.





BIRI I POSTËS SË KUFIRIT

Në janar-shkurt të vitit 1945 forcat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare hynë në Kelmend për ta pas-truar njëherë e mirë atë krahinë nga mbeturinat e bandave reaksionare të cilat ishin strukur nëpër vrima e shpella dhe terrorizonin popullin e shumë-vuajtur të atyre anëve në një kohë kur e gjithë Shqipëria ishte çliruar dhe populli gëzonte lirinë. Banditët me vrasjet djegjet dhe grabitjet ja ki-shin sjellë shpirtin popullit në majë të hundës. Për këtë arsye qysh se forcat partizane hynë në katundet e krahinës së Kelmendit ato u pritën nga populli si çlirimtare. Partizanët shpinin në ato vi-se fjalën e zjarrtë të partisë dhe në sajë të qën-drimit të tyre korrekt dhe të ngrohtë me popullin, por të rreptë e të papajtueshëm me banditët dhe armiqtë bënë që bile edhe një pjesë e fshatarëve të gënjyer të bashkoheshin shumë shpejt me ta, t'u hapnin zemrën dhe t'i prisnin në vatrën e tyre si djemtë e tyre. Në sajë të kësaj lidhjeje të ngush-të me popullin forcat partizane e kryen shpejt dhe shumë mirë detyrën e tyre luftarake. Ky suk-ses natyrisht nuk u arrit lehtë. Forcave partizane ju desh të kalonin mjaft vështirësi si të natyrës, motin e keq, ashtu dhe vështirësi të tjera. Bandi-

tët që e njihnin mirë terrenin dhe kishin përkrashjen e bajraktarëve, të parisë dhe të klerit rezistonin me tërbim. Por forcat partizane i shfarosën banditët dhe reaksionarët mu në strofkat e tyre sepse ditën veç të tjerave të lidheshin ngushtë me popullin sidomos me rininë dhe me pionierët. Banditët nuk i shpëtonin dot syrit vigjilent të partizanit, të të riut dhe të fëmijëve. Partizanët mbetën të mahnitur shumë herë nga patriotizmi i lartë nga mikpritja dhe besa e malësorëve trima e të thjeshtë të asaj krahine që fjala e partisë i përtëriu dhe tek të cilët ajo u rrënjos shumë shpejt si një farë e hedhur në një tokë pjellore.

Të rinjtë dhe fëmijët u miqësuan shumë shpejt me partizanët dhe u tregonin atyre udhët, vendet e strehimit emrat e kriminelëve dhe mirrin pjesë me ta bashkë në operacionet. Emrat Parti, Enver, partizan u bënë për ata fjalët më të dashura dhe i mbushnin me krenari.

Njëherë në komandën e forcave partizane erdhën një vajzë dhe një djalë nja 6 vjeç. Fëmijëve u merrej fryma dhe mezi flisnin. Vajza tha se partizanët kishin shkuar në shtëpinë e saj dhe kërkonin të bënin sekuestrim. Ajo nuk e quante të drejtë këtë veprim dhe kërkonte që të pezullohej urdhëri pasi asnjëri nga familja e saj nuk ishte në radhët e banditëve. Kur po fliste vajza, ndërhynte në bisedë edhe vocrraku 6-vjeçar dhe me një guxim e kurajë të habitshme vërtetonte ato që thoshte vajza. Komandantit dhe zëvendëskomisarit u bëri përshtypje kjo gjë dhe po e shikonin me admirim këtë fëmijë që fliste si burrë. Natyrisht ata ndërhyjnë në bisedën e tyre me ndo-

një shaka dhe verifikuan për sa kërkonin fëmijët. Doli se ata kishin të drejtë. Në listat e shtëpive të krerëve reaksionarë që komanda partizane kishite vendosur të bëhej sekuestrim nuk figuronte shtëpia e vajzës. Kur u njoftuan se ata kishin të drejtë dhe ata panë që u dërgua me ngut një korrier për të lajmëruar partizanët se ishin drejtuar gabimisht, fëmijët u hodhën përpjetë nga gëzimi dhe duke bërëtitur të emocionuar ngritën grushtin dhe thanë: «Vdekje Fashizmit!» Pastaj fluturuan si dy zogj plot hare.

Kur ata u larguan, zëvendëskomisari i tha komandantit: «Sa i gjallë ai dreqi dhe me sa bindje fliste. Të tundte».

— Shpuzë, tamam malësor, i zgjuar trim dhe bujar, ju përgjegj komandanti.

Ky vocrrak ishte Nik Pjetër Ndreka, i cili 6 vjet më vonë do të binte nga thika e diversantëve të UDB-së jugosllave dhe që presidiumi i Kuvendit tonë Popullor i dha titullin e lartë të Heroit të Popullit pas vdekjes dhe urdhërin e trimërisë.

Për Nik Pjetër Ndreken, për heroin më të vogël në moshë midis heronjve tanë flasin sot kufitarët e asaj ane, shokët e mësuesit e tij të shkollës dhe aktin e tij heroik e di gjithë vendi.

Me të jatin e Nikës, Pjetër Ndreken, u njoha tani vonë, kur i shkova në shtëpi për ta uruar me rastin e shpalljes së Nikës Hero i Popullit. Biseda me Pjetër Ndreken ishte e ngrohtë dhe e përmallshme. Ai e ndjente veten krenar për të birin dhe fjalët Parti, Enver nuk i hiqte nga goja. Aktin heroik të Nikës unë e kam jetuar vetë, por disa episode karakteristike nga jeta e tij nuk i dija. Këto m'i tregoi shtruar e pa mburrje sikur

fliste për gjëra më se të zakonshme, vetë i jati i Nikës.

* * *

— Kur më lindi djali i dytë, Nika, në korrik të vitit 1939, u gëzova tepër, me mua u gëzuan edhe njerëzit e tjerë të familjes dhe të fisit. Atëhere ishte zakoni që kur lindte djalë shkruhej pushkë, — tha Pjetër Ndreka dhe vazhdoi. — Këto zakone ne tani po i lemë, se kështu na mëson partia. Vajza apo djali për prindërit njësoj janë. Ja Shkurta e Pal Vatës na i zbardhi faqen të gjithëve, edhe pse ishte vajzë. U gëzuam kur lindi Nika, por hallet na u shtuan. Unë si shumica e fshatarëve isha i varfër dhe fëmijë të shumë s'kishin me se t'i ushqej. Në atë kohë kur lindi Nika jeta jonë ishte e rëndë. Vendin e kishte pushtuar fashizmi. Bajraktarët e paria si gjithnjë na tradhëtuan dhe u bashkuan me pushtonjës. Por kohët kaluan. Lindi partia dhe ajo na solli lirinë. Asaj ja kemi borxh edhe jetën tonë...

Nika ishte 6 vjeç kur në fshatin tonë erdhën partizanët me të cilët ai lidhi miqësi të ngushtë. Më vonë ai lidhi miqësi me kufitarët. Ata e donin shumë dhe shpeshherë e shikoje midis kufitarëve. Që në këtë moshë ai ishte një fëmijë e gjallë e shkathët dhe e patrembur. Ai nuk dinte ç'ishte frika. Po ju tregoj vetëm një rast.

Një herë unë dhe gruaja ime u sëmurëm rëndë. Kishim temperaturë të lartë dhe të vjella. Ishim shtrirë në të dyja anët e vatrës dhe po përpëliteshim ndër ethe. Nëna ime dhe dy fëmijët na rrinin përkarshi dhe na shikonin të pikëlluar. Nuk kishin si të na ndihmonin. Në të ngrysur m'u kuj-



tua mjeku i cili ndodhej në një katund aty afër dhe u thash kalamajve të shkonin atë ças për ta thirrur.

— Babë! Po shkoj unë — tha Nika dhe pa pritë përgjegjen time doli jashtë. Së bashku me të doli dhe gjyshja që e hypi në kalë dhe e porosi të kthehej shpejt se prindërit ishin rëndë. Ajo edhe ishte e bindur se Nika do ta kryente porosinë edhe trembej për të se ai ishte fëmijë dhe nata ka të papriturat e saj.

S'kaluan as tre orë dhe te ne erdhi doktori. Nika e kishte gjetur atë i kishte shpjeguar gjendjen tonë dhe i ishte lutur të vinte të na shpëtonte. Doktorit ai i kishte dhënë kalin dhe vet ishte nisur në këmbë bashkë me një fshatar.

Doktori na shpëtoi. Aktin e Nikës e mori vesh gjith katundi.

* * *

Edhe në shkollë Nika i vogël dallohej në mësimet dhe në sjellje.

— Ke një djalë o Pjetër, — i kishte thënë një herë mësuesi, babait të Nikës, që s'i gjendet shoku, i zgjuar, i ndigjueshëm dhe i urtë. E kemi më të mirin në shkollë...

Nika një ditë u kthye në shtëpi i mërzitur dhe, pa hyrë mirë në derë i tha babait:

— Mësimi i sotëm nuk më ka pëlqyer fort, mbasi mësonjësi kur foli për vendin tonë harroi me përmend Dedë Gjon Lulin, partizanët dhe kufitarët që kanë luftue dhe luftojnë për Shqipërinë.

— Jo mor djalë, — iu përgjegj i ati, — sot

ndoshta nuk e kishin radhën ata. Gjithnjë mësuasi nuk do të flasë për këta.

— Po babë, po. Ishte rasti me i prek edhe këta, por ai harroi.

Dhe atë ditë i prirë nga këto mendime ai shkroi me dorën e tij të vogël vargjet e para. Ndërsa mbasdite kur fshati ishte mbledhur, ai doli befasi midis njerëzve dhe iu lut të thoshte disa fjalë. Malësorët dhe malësoret, të gjithë sa ishin aty, panë në sy njëri-tjetrin dhe tundën kokën në shenjë aprovimi.

Fëmija 8 vjeçar lexoi tërë seriozitet vargjet që i kish thurur Partisë, shokut Enver, kufitarëve, dhe ku bënte thirrje për vigjilencë kundër armiqve dhe diversantëve: «Që në çdo skutë t'jau bëjmë atyre kokën copë dhe të mos gjejnë vrimë miu ku të futen». Këto vargje kumbuan si kushtrim për të gjithë pjesëmarrësit. Njeri prej tyre, më i moshuari i emocionuar tha:

— Mua sytë dhe veshët më kanë lënë, por në mos gabohem, ky është vocrraku i Pjetër Ndre-kës. Po bir, këto që thua ti edhe na duhet me i mësuë, t'i bajmë tonat. Lum shpija e malësia, shkolla e tan vendi për ty, o sokol i vogël, i këtyne maleve.

Kështu u fliste ai edhe moshatarëve të tij dhe u kujtonte atyre detyrën e tyre si pionierë karshi Atdheut.

Në një rast Nika e kritikoi shumë njërin nga shokët e tij, i cili duke biseduar i tregoi se një ditë kishte parë në pyll një person të panjohur dhe megjithëse kishte dyshim për të, nuk kishte njoftuar postën e kufirit.

— Po të veprojnë të gjithë pionierët kështu

si ti është e kotë që e mbajnë këtë emër. I harrove porosinë që na dha oficeri i kufirit gjatë bisedës që na bëri në shkollë me rastin e 25 Prillit? ¹⁾ Ai nuk na quajti kot ushtarë të vegjël pa uniformë.

Nik Pjetër Ndreken, e lidhte një miqësi e veçantë me kufitarët që i donte, i dëgjonte, i respektonte pa masë. Ai ishte aq i afërt me efektivin e postës sa një ditë njëri nga kufitarët e quajti atë bir të postës së kufirit. Me të dëgjuar këto fjalë, Nika gati kish fluturuar nga gëzimi, por e kish mbajtur veten se nuk i pëlqente të mburrej dhe të dukej më shumë nga të tjerët.

Pionieri kishte dëshirë të madhe për të mësuar nga kufitarët që ta meritonte plotësisht emrin që i kishin vënë ata. Veçanërisht Nikën e tërhiqnin episodet e Luftës nacionalçlirimtare dhe ngjarjet në kufi mbi kapjen ose likuidimin e diversantëve.

Për Nikën e vogël ruajtja e kufirit ishte bërë një detyrë e shenjtë dhe e përhershme. Ai shpesh vriste mendjen të mësonte se si ta ruante kufirin, si t'i zbulonte diversantët, ose ç'mënyra përdorin shkelësit për ta kaluar kufirin pa u diktuar, si fshihnin gjurmat, çfarë veshje mbanin dhe si maskoheshin. Këto i diskutonte me kufitarët, me komandën e postës dhe përgjegjet që merrte i fiksonte në kokë, i përpunonte, dhe përgatiste çdo ditë si kufitar i vërtetë planin e ruajtjes së kufirit së bashku me çetën e pionierëve, komandant i së cilës ai ishte. Por këtë përgatitje Nika e bënte pa rënë në sy të të tjerëve dhe sidomos

1) Dita e formimit të Armës së kufirit.

të armiqve, bile në disa raste ai tregohej i rezervuar edhe me shokët.

Kur ai delte afër kufirit për të ruajtur bagëtinë, i lëshonte ato në lëndinë, hipte në pemë ose në ndonjë vend dominues dhe duke shikuar e përgjuar ruante delet dhe kufirin.

Oficerët e gjithë efektivit i postës kishin besim se në drejtimin ku ndodhej bariu i vogël me delet, kish pak mundësi për t'u kaluar kufiri pa u diktuar, sepse po të ndodhte gjë, Nika, të paktën, do të njoftonte postën. Dhe në të vërtetë atij i qe bërë zakon të kalonte shpesh nga posta e kufirit, të raportonte mbi të rejat e ditës. Në shumë raste të dhënat e tij u kishin shërbyer forcave tona për ruajtjen e kufirit.

* * *

Në një nga ditët e bukura të qershorit të vitit 1952 nxënësit e klasës së katërt të gëzuar për mbarimin me sukses të shkollës fillore, ishin ndarë më dysh dhe luanin futboll me një top lecke të një fushë e vogël, jo shumë larg postës së kufirit. Nika këtë radhë nuk luante, se një ditë më parë atij i qenë bërë këmbët plagë në lojë nga telat e opingave të disa shokëve, dhe ai vetëm arbitronte këtë ndeshje «interesante e shumë dinamike».

Më tej, në oborrin e postës së kufirit komandanti kish mbështetur armën në vendin e pas-trimit dhe i bënte asaj shërbimet e duhura duke ndjekur njëkohësisht edhe ndeshjen e fëmijëve, në të cilën merrte pjesë djali i madh i tij.

Oficeri megjithëse nuk ishte tifoz i madh i futbollit anonte më shumë nga skuadra e djalit, por për arësye taktike nuk e shfaqte tifon e tij dhe në dukje mbante qëndrim asnjës.

Pas mbarimit të lojës Nika së bashku me djalin e komandantit iu afrua komandantit dhe e vështronte me kureshtje të madhe. Herë-herë ai mundahej t'ia prekte me dorë armën.

— E, të pëlqen? — e pyeti komandanti.

— Besa po, kisha me marrë një kësisoj megjithqef.

— E ç'e do.

— Me ruajt kufinin, sikurse ju, e me ja shkrep ndonjëherë në lule të ballit ndonjë spiuni që do me kalue këtej pari.

Komandanti qeshi me të madhe, pastaj mbasi e përkëdheli pionierin duke i lëmuar flokët, i tha:

— Edhe kështu si jeni, pa armë, ju mund ta ruani kufirin dhe në fakt na keni ndihmuar shumë. Mjafton që të zbuloni e të na lajmëroni për çdo person të dyshimtë, pastaj dimë ne si të veprojmë.....

Nika e dëgjoi me vëmendje oficerin e kufirit dhe po mendonte për t'u bërë oficer i kufirit.

Nika e kishte bërë zakon që mbasi kthehej nga shkolla në shtëpi, çlodhej pakë dhe ulej për të përgatitur detyrat. Pastaj merrte delet, librat dhe dilte mbi fshat për të kullotur bagëtinë. Ai në një kohë ruante bagëtinë, kufirin edhe lexonte. Kur u mbyllën shkollat ai nuk hoqi dorë nga këto tre detyra dhe duke e quajtur librin shokun e tij më të ngushtë, nuk e linte asnjëherë atë pa e marrë me vete; me ndryshim që tanimë në

vend të librave shkollore ai lexonte libra të tjera, të cilat e tërhiqnin shumë.

Qershori ishte në mbarim e sipër. Nika kish-te dalë me bagëti në një pllajë të bukur mbi fshat dhe këtë radhë ndryshe nga ditët e tjera që ulur në majë të një shkëmbi dhe i binte fyellit.

Por fyelli nuk ja largonte vëmendjen Nikës nga kufiri. Në një rast duke përgjuar ai pa se në një ferrë, lëvizte diçka. Nika e përqëndroi aty vëmendjen dhe pas pak ai pa aty dy persona të armatosur, të veshur me uniformë ushtarake si të kufitarëve tanë.

— Ç'të jenë? — mendoi ai, — po të ishin kufitarët pse nuk më pyetën mua mbi të rejat, ata më panë. Atij ju kujtuan fjalët e oficerit të postës: shkelësit e kufirit në disa raste, për t'u maskuar vishen me uniformën e kufitarit. Nika trembi delet me kujdes të madh, i kaloi ato në një gropë dhe me shpejtësi vrapoi në postë.

— Diversantët! — i tha ai me gjysëm zëri oficerit të kufirit duke i treguar me dorë vendin. Grupi i alarmit me në krye komandantin brenda dy minutave u nis në drejtimin ku ishin zbuluar shkelësit e kufirit. Nika i doli grupit përpara dhe u orvat që ta përçonte atë.

— Ti qëndro, — i tha oficeri, — ne e dimë vendin, nuk është mirë të vish këtë radhë me ne.

— Por unë kam bagëtitë atje, me kë t'i le?

— Delet nuk pësojnë gjë, mbasi të mbaroj veprimi shkojmë ne dhe i marrim, — ja preu komandanti.

Në fillim pionieri u mërzit, por mbas pak e mblodhi veten, sepse në fund të fundit e bëri detyrën e tij, i zbuloi shkelësit dhe njoftoi postën e kufirit. Por Nika nuk qëndroi gjatë në këto mendime, sepse mbas 2 orësh ai pa grupin që i afrohej postës dhe u turr me shpejtësi në drejtim të tij, gufoi nga gëzimi kur pa diversantin e lidhur e kur mori vesh se edhe i dyti në përpjekje e sipër ishte vrarë. Ndërsa në mbrëmje ai u gëzua edhe më shumë, kur i shkoi në shtëpi komandanti i postës, i cili duke i hedhur djalit dorën në sup, i tha Pjetrit se një meritë e madhe për kapjen e diversantëve i takonte Nikës.

* * *

Kaloi gati një muaj që nga ajo ditë. Nika kish dalë përsëri me bagëti dhe këtë radhë qe larguar më shumë se çdo herë tjetër nga fshati me qëllim që t'u gjente dhenve vend të përshtatshëm për kullotje. Bashkë me të ndodhej edhe baresha Drane, e cila e afroi tufën për të mësuar nga vocrraku mbi zbulimin e bandës së diversantëve. Nika ishte shtrirë në një lëndinë si burrë i madh. Karshi tij qe Drana, e cila e ulur në bisht dëgjonte me vëmendje të madhe tregimin e Nikës. Mirëpo biseda nuk zgjati shumë se Nika mbasi i tregoi Dranes se si u kapën diversantët, u ngrit, i trembi delet për t'i kaluar ato në një gropë tjetër se kullotën që kishin përpara e kishin ngrënë. Edhe Drania kur pa që tufa e saj ishte shkëputur goxha vrapoi me shpejtësi në drejtim të saj.

Delet e Nikës ju turrën kullotës së re dhe e pastruan me shpejtësi. Bariu i vogël ishte duke lexuar librin dhe kur ngriti kokën vuri re se tre nga delet qenë shkëputur nga tufa dhe kullosnin në një vend jo të përshtatshëm. Ai u nis t'i trembte për t'i bashkuar me të tjerat, por në rrëzë të një dushku dëgjoi zëra dhe më vonë pa tre vetë të veshur me rroba ushtarake dhe të armatosur, për të cilët që në fillim dyshoi se ishin diversantë.

Nika bëri sikur nuk i pa ata dhe u nis me të shpejtë drejt tufës, por nga pas ndjeu këmbët dhe më vonë zërin e njërit prej tyre që qe nisur në drejtim të tij.

— Ej, more vocërr! Prej nga je ti?

— Nga ky katund jam, — u përgjegj pionieri, pa e ngritur kokën.

— Mos u tremb, unë dua të të pyes për diçka. Sa larg është katundi prej këtej. Cili është sekretari i organizatës së partisë dhe cili kryetari i këshillit.

— Fshati nuk është më larg se një orë, ndër-
sa për sekretarin dhe kryetarin, ç'a di unë, nuk i njoh, shkoni në fshat dhe atje jua tregojnë.

— Si ti, pispiruaq, nuk i di emrat e tyre, — dhe i panjohuri e kapi nga dy veshët Nikën aq fort sa atij i dualën lot nga sytë, — trego se t'i këputa llapushet!

— Nuk di gjë, nuk di gjë, unë jam i vogël!
— u përgjegj prerazi dhe me urrejtje Nika.

— Mirë qërohu, por veç ndigjo, — i tha në mënyrë kërcënuese diversanti, — mos i kallëzo kuj që je pa dhe ke folur me ne!

Paralajmërimi e bëri malësorin e vogël të dy-

shonte më shumë. Ai zbriti me kujdes të madh nja 300 metra më poshtë takoi bareshën dhe i tha asaj që të lajmëronte sa më parë postën e kufirit.

Diversantëve u bëri përshtypje qëndrimi i Nikës, por nuk dyshuan shumë. Megjithatë, për çdo eventualitet dhe për të qenë më të sigurt, ata u larguan nga vendi i parë, duallën në një shpat tjetër, u vendosën në disa shkure dhe filluan të vrojtonin nga maja e një shkëmbi. Mbas pak njeri prej tyre ai që vrojtonte, duke vërtitur dylbinë kapi Dranën që vraponte me shpejtësi për në katund, në anën e të cilit ishte vendosur posta e kufirit.

— Ah, na paska kallëzuar lapuraku, — i tha ai kapobandës dhe sapo mbaroi këto fjalë pa Nikën të kalonte aty pranë. Nika gjoja se po mblidhte bagëtinë vështronte diversantët.


Agjentët e UDB-së jugosllave ju turrën Nikës si bisha. Njëri i zuri gojën me shami, të tjerët e lidhën. Ai e kuptoi që kishte rënë në grackë dhe tentoi t'u shkëputej nga duart, por nuk mundi. Pastaj filloi t'i qëllonte banditët me shkelma e t'i pështynte.

— Ku e dërgove bareshën dhe përse? ëëë kallëzo!

— Nuk tregoj asgjë, lëshomëni, lëshomëni!
— thërriste Nika.

Xhelatët e Titos u sulën të egërsuar mbi fëmijën, e qëlluan me pëllëmbë dhe shkelma, e kërcënuan me thika dhe revole, por ai nuk u frikësua, s'u tha asnjë fjalë armiqve, qëndroi si burrat dhe s'derdhi asnjë pikë loti.

— Më bani ç'të doni, po s'keni ku me shkue... , s'keni ku me shkue... — dhe kur ai mbaroi së



shqyptuari këto fjalë, një thikë hyri thellë në shpinën e tij të njomë dhe një gur i rëndë rambi kokën e tij të vogël.

Për të humbur gjurmët e këtij krimi barbar, diversantët e hodhën kufomën nga shkëmbi në një humnerë.

Për postën e kufirit, e cila nga që ishte distanca e **largët nuk mundi t'i vinte** në kohë në ndihmë birit të saj të dashur, vdekja e Nikës ishte një humbje e madhe, por ajo bëri çmos që korbat e zinj të Titos të mos shpëtonin dhe ta paguanin me lëkurën e tyre krimin monstruos, ashtu si të gjitha krimet e tjera. Kufitarët të prekur thellë nga kjo humbje mbyllën me shpejtësi shtigjet dhe mbas një veprimi të rrufeshëm dy diversantët i vranë, ndërsa njerin e zunë të gjallë. Banditi i kapur gjatë hetuesisë deponoi mbi qëndrimin heroik të Nik Pjetrit.

Nik Pjetër Ndreka, heroi ynë më i vogël, mbeti simbol i pionierit të vërtetë të epokës sonë revolucionare. Qëndrimi dhe vepra e tij tregojnë se në vendin tonë për ruajtjen e kufirit dhe mbrojtjen e Atdheut janë të gjithë gati, pavarësisht nga mosha e seksi, janë të gjithë kufitarë, ushtarë me ose pa uniformë.

Pionieri hero, ndonëse nuk arriti ta veshë asnjëherë uniformën ushtarake për të cilën ëndërronte, nuk e ngjeshi dot armën në trupin e tij të vogël, por me veprën e tij mbeti kufitar i përhershëm, i pavdekshëm.

57862

LIBRARI E SHKËMBI

GJYRKASHTER

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kufi aktiv	5
Edhe të liruar kufitarë	12
I pamposhtur	20
Hoteli i gjahtarëve	29
Njeriu me borsalino	47
Në faqen e malit	57
Përleshje te shkëmbi i vetmuar	64
Katër gjallë një i vrarë	68
Këmbët e ngrira	73
Ndërgjegjja e kufitarit	78
Inicialet e përgjakura	82
Gra me zemër ushtari	85
Gracka	89
Punëtorët në pozicione	91
Biri i postës së kufirit	96